



Република Србија



ПОВЕРЕНИК ЗА  
ЗАШТИТУ  
РАВНОПРАВНОСТИ

# Komesari për mbrojtjen e barazisë

## Raport i shkurtuar për vitin 2012

Komesari për mbrojtjen e barazisë

Raport i shkurtuar për vitin 2012

# **Komesari për mbrojtjen e barazisë**

---

**Raport i shkurtuar për vitin 2012.**

Beograd, maj 2013.

# **Komesari për mbrojtjen e barazisë**

Raport i shkurtuar për vitin 2012.

## **Redaktore**

Prof. dr. Nevena Petrushiq, komesare për mbrojtjen e barazisë

## **Botues**

Komesari për mbrojtjen e barazisë

## **Për botues**

Prof. dr. Nevena Petrushiq

## **Përkthimi dhe lektura**

Eurokontrakt d.o.o., Beograd

## **Dizajni dhe kopertinat**

Impres

## **Faqosjen**

Althea

## **Shtypjen**

Klik Tim d.o.o.

## **Tirazhi**

200



Botimin e kësaj broshure e ka financuar Delegacioni i BE në Serbi nëpërmjet Projektit IPA 2011 “Zbatimi i politikave antidiskriminuese në Serbi”.

Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit/autores dhe nuk i përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Të gjitha nocionet e përdorura në Raport në gjininë gramatikore  
mashkullore e përfshijnë gjininë mashkullore dhe femërore  
të personave të cilëve u referohen



Shtypjen e broshurës e ka mbështetur Bashkimi Evropian nëpërmjet Projektit IPA 2011 “Zbatimi i politikave antidiskriminuese në Serbi“. Projekti ka për qëllim që të përforcojë kapacitetet institucionale të Zyres për të Drejta të Njeriut dhe të Drejta të Pakicave të Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe të Komesarit për mbrojtjen e barazisë për zbatimin më efikas të politikave antidiskriminuese në pajtim me standardet dhe praktikatat e mira të Bashkimit Evropian.

Project implemented by:



# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
PËRMbledhja .....	8
<b>1. VEPRIMI I KOMESARIT PËR MBROJTJEN E BARAZISË PËR PARANDAL- IMIN E DISKRIMINIMIT DHE PËR PËRPARIMIN E BARAZISË .....</b>	<b>10</b>
1.1 Veprimi sipas ankesave .....	12
1.2 Proceset për mbrojtjen nga diskriminimi .....	19
1.3 Veprimet kundërvajtëse .....	21
1.4 Denoncimet penale .....	22
1.5 Rekomandimet organeve të pushtetit publik.....	22
1.6 Nismat e legjislacionit dhe mendimet për dispozitat.....	23
1.7 Paralajmërimet dhe kumtesat e opinionit .....	24
1.8 Vendojsja e sistemit të shërbimeve të ndërmjetësimit në kuadër të shërbimit të komesarit .....	24
<b>2. SHËRBIMI PROFESIONAL DHE ZHVILLIMI I INSTITUCIONIT TË KOMESARIT PËR MBROJTJEN E BARAZISË .....</b>	<b>28</b>
<b>3. GJENDJA NË REALIZIMIN DHE MBROJTJEN E BARAZISË DHE VEPRIMI I KOMESARIT .....</b>	<b>32</b>
3.1 Raporti i qytetarëve ndaj diskriminimit – Hulumtimi i opinionit publik .....	33
3.2 Diskriminimi në bazë të gjinisë dhe identitetit gjinnor .....	35
3.3 Diskriminimi në bazë të përkatësisë kombëtare dhe originës etnike.....	39
3.4 Diskriminimi në bazë të invaliditetit .....	44
3.5 Diskriminimi në bazë të orientimit seksual.....	46
3.6 Diskriminimi në bazë të statusit martesor dhe familjar.....	47
3.7 Diskriminimi në bazë të gjendjes pronësore .....	48
3.8 Diskriminimi në bazë të moshës.....	48
3.9 Diskriminimi në bazë të anëtarësisë në organizata politike, sindikale dhe të tjera .....	49
3.10 Diskriminimi në bazë të bindjeve fetare dhe politike .....	50
3.11 Diskriminimi në bazë të veçorive të tjera personale.....	51
3.12 Fusha e marrëdhënieve shoqërore me të cilat kanë të bëjnë ankesat .....	51
3.12.1 Puna dhe punësimi.....	52
3.12.2 Veprimi i organeve të pushtetit publik.....	54
3.12.3 Dhënia e shërbimeve, shfrytëzimi i objekteve dhe sipërfaqeve.....	56
3.12.4 Informimi publik dhe mediat.....	56
3.12.5 Arsimimi dhe aftësimi profesional.....	57
<b>4. BASHKËPUNIMI DHE PËRURIMI I BARAZISË.....</b>	<b>58</b>
4.1 Përparimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për testimin e situatës lidhur me diskriminim .....	60
<b>5. MEDIA MONITORIMI I PUNËS SË KOMESARIT DHE RAPORTIMI PËR DISKRIMINIM .....</b>	<b>62</b>

6.	Projektet .....	63
7.	Veprimtaria botuese .....	66
8.	Kryerja e obligimeve sipas Ligjit për trajtim të lirë të informatave me rëndësi publike.....	67
9.	Rekomandimet për zhdukjen e diskriminimit dhe përparimi i barazisë .....	68

## HYRJE

Të nderuar deputetë të popullit,  
Të nderuar lexues,

Pas nesh është edhe një vit i punës së vazhdueshme. Gjatë vitit të kaluar Komesari për mbrojtjen e barazisë e ka vazhduar punën për zhdukjen e diskriminimit dhe është përpjekur që maksimalisht të afirmojë parimet e barazisë, e mundësive të barabarta dhe tolerancës, duke i kontribuar me këtë vendosjes së Sistemit të vlerave në të cilin të qenët më ndryshe i identiteteve njerëzore pranohet, respektohet dhe kuptohet si pasuri dhe potencial i zhvillimit shoqëror. Kjo përpjekje e Komesarit vërehet dhe është vlerësuar pozitivisht edhe në Raportin e Komisionit Evropian për përparim në Republikën e Serbisë në vitin 2012, në të cilin theksohet se Komesari për mbrojtjen e barazisë ka qenë aktiv në ngritjen e vetëdijes për diskriminim dhe mënyrat e zhdukjes së tij, si edhe për përforcimin e mekanizmeve ekzistues për mbrojtjen e diskriminimit.

Në vitin e kaluar Komesari ka vepruar në kuadër të pesë fushave kryesore. Para se gjithashë, Komesari i ka zbatuar procedurat sipas ankesave për shkak të diskriminimit, numri i të cilave gjatë vitit 2012, është shtuar për gati 40% në krahasim me vitin 2011. Komesari ka punuar për mënjanimin e shkaqeve të diskriminimit, ngritjen e vetëdijes së opinionit dhe përparimin e barazisë, për përfurimin dhe shtimin e dukshmërisë dhe arritshmërisë së vet në tërë rajonin e Serbisë, si edhe për përparimin e transparencës së punës.

Raporti i shkurtuar i cili gjendet para Jush përfshin periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2012. Në raport, në bazë të të dhënave në disponim, është përshkruar gjendja aktuale në fushën e realizimit dhe të mbrojtjes së barazisë, janë theksuar format më të shpeshta të diskriminimit, si edhe ato fusha të marrëdhënieve shoqërore në të cilat është më i përhapur diskriminimi.

Shpresoj se ky raport do të jetë nxitje që të gjitha organet e pushtetit publik, në kuadër të kompetencave të veta, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, të përshpejtojnë punën për parandalimin dhe zhdukjen e diskriminimit në Serbi dhe krijimin e shoqërisë së hapur, tolerante dhe inkluzive të bazuar në të drejtat e njeriut dhe në parimet e mbizotërimit të të drejtave, i cili të gjithëve u ofron mundësi të barabarta.

Dr. Nevena Petrushiq,  
Komesare për mbrojtjen e barazisë



## Përmbledhja

Gjatë vitit 2012 Komesari për mbrojtjen e barazisë ka vazhduar veprimin e vet për zhdukjen e të gjitha formave, mënyrave dhe rasteve të diskriminimit dhe për përparimin e barazisë, duke i përdorur të gjitha autorizimet e veta ligjore.

Gjatë vitit 2012, Komesarit i janë dërguar 465 ankesa, gjë që gati 40% janë më shumë në krahasim me vitin 2011. Kësaj i kanë kontribuar aktivitetet e Komesarit në planin e informimit të qytetarëve për diskriminim dhe mënyrat e mbrojtjes nga diskriminimi, si edhe për shtimin e transparencës së Institucionit të Komesarit. Gjatë vitit të kaluar janë dhënë 29 mendime, 27 mendime me rekomandim, 117 rekomandime organeve të pushtetit publik që të ndërmarrin masa për përparimin e barazisë, si edhe tri mendime për ligje. Kanë filluar pesë procese gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi dhe janë lëshuar 19 paralajmërime dhe kumtesa.

Në mesin e ankesave të paraqitura më së shumti ka nga ato në të cilat si bazë e diskriminimit theksohet invaliditeti, përkatësia kombëtare /origjina etnike, gjinia, bindjet fetare dhe politike, mosha, anëtarësimi në organizata politike, sindikale ose në organizata të tjera, statusi martesor dhe familjar etj. Numri më i madh i ankesave i është referuar diskriminimit në fushën e punës dhe të punësimit, diskriminimin në procedurat para organeve publike të pushtetit, në arsim dhe në aftësim profesional, dhënien e shërbimeve publike dhe shfrytëzimin e objekteve dhe sipërfaqeve etj.

Edhe gjatë vitit të kaluar realativisht një numër i madh i ankesave të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave për të cilat Komesari nuk është kompetent, gjë që tregon se qytetarët ende nuk janë njohtuar mjaft me nocionin e diskriminimit dhe me kompetencat e Komesarit.

Komesari ka punuar në mënyrë intensive në përrurimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, përmes ligjëratave dhe prezantimeve, duke organizuar tubime përruruese, me pjesëmarrje në konferenca, në tubime profesionale dhe në tryeza të rrumbullakta të organizatave të shoqërisë civile. Është vendosur dhe është thelluar bashkëpunimi me organe të pavarura dhe me organe të tjera shtetërore, me institucione të ngjashme në botën e jashtme, me organizata ndërkombëtare, si edhe me organizata të shoqërisë civile. Komesari me kapacitet të plotë i ka realizuar favorozimet, të cilat i ofron anëtarësimi në Rrjetin Evropian të Organeve për Barazi (EQUINET).

Është hartuar Plani strategjik i zhvillimit i Komesarit dhe Strategjia e komunikimit me Planin e veprimit për periudhën 2012-2014. E ka filluar punën për vendosjen e sistemit të shërbimeve të ndërmjetësimit në kuadër të shërbimit të Komesarit. Është zbatuar hulumtimi i opinionit publik “Raporti i qytetarëve ndaj diskriminimit në Serbi”, i cili e ka bërë të mundur të mësohet sa kanë njohuri qytetarët për diskriminim, sa është niveli i disancës sociale dhe entike midis

disa grupeve shoqërore, si edhe sa është transparent në opinion për institucionin e Komesarit. Janë publikuar 11 libra, doracakë dhe broshura. Të punësuarit në shërbim profesional i kanë përparuar kompetencat e veta profesionale, kurse vetë institucioni i Komesarit është bërë më transparent, më i hapur dhe më i kontaktueshëm.

Gjatë periudhës së kaluar mediat në mënyrë intensive e kanë përcjellë dhe e kanë njohtuar opinionin për punën e Komesarit dhe i kanë transmetuar kumtesat, qëndrimet dhe mendimet e tij.

Në vitin 2012, Komesarit për mbrojtjen e barazisë i janë lejuar 89.471.000,00 dinarë, kurse me Ligjin për buxhet për vitin 2013 për punë të Komesarit janë parashikuar mjetet në shumën prej 89.348.000,00 dinarësh.

## 1. Veprimi i Komesarit për mbrojtjen e barazisë për parandalimin e diskriminimit dhe përparimin e barazisë

Diskriminimi, përkatësisht, veprimi diskriminues është secila bërje e dallimit pa arsye ose veprim jo i barabartë, përkatësisht lëshim (përbashkëtim, kufizim ose dhënie e përparësisë), në krahasim me personat ose grupet si edhe ndaj anëtarëve të familjeve të tyre, ose personave të afërt me ta, në mënyrë të hapur ose të fshehur, e që bazohet në racë, ngjyrë të lëkurës, paraardhësit, shtetësi, përkatësi kombëtare ose origjinë etnike, gjuhë, bindje fetare ose politike, gjini, identitet gjinor, orientim seksual, gjendje pronësore, veçori gjenetike, gjendje shëndetësore, invaliditet, status martesor ose familjar, dënueshmëri, moshë, pamje, anëtarësim në organizata politike, sindikale dhe në organizata tjera dhe në veçori të tjera reale, përkatësisht të supozuara personale<sup>1</sup>.

*Ligji për ndalim të diskriminimit i* përcakton mbi njëzet veçori personale në bazë të të cilave diskriminimi është i ndaluar, por kjo listë nuk është definitive, përkatësisht, ligjdhënësi e ka lënë mundësinë që kjo të jetë edhe ndonjë veçori tjetër personale e cila nuk është numëruar shprehimisht në ligj.

**Komesari për mbrojtjen e barazisë** është organ i paanshëm dhe i pavarur dhe i specializuar shtetëror, i vendosur me Ligj për ndalimin e diskriminimit<sup>2</sup> dhe është **organ qendror i shtetit për luftën kundër të të gjitha formave të diskriminimit**. Komesare për mbrojtjen e barazisë është dr. Nevena Petrushiç, të cilën Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë e ka zgjedhur më 5 maj të vitit 2010.

Kompetencat ia mundësojnë Komesarit që në mënyrë efektive të parandalojë dhe të mbrojë nga diskriminimi dhe t'i kontribuojë realizimit dhe përparimit të barazisë, e këto janë:


- Veprimi sipas ankesave në rastet e diskriminimit të personave ose grupeve të personave të cilat i lidh e njëjta veçori personale
- Proceset gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi
- Veprimet kundërvajtëse
- Rekomandimet e organeve të pushteti publik
- Nismat legjislative dhe mendimet për dispozitat
- Paralajmërimet dhe kumtesat e opinionit

<sup>1</sup> Neni 2, paragrafi 1, pika 1, e Ligjit për ndalimin e diskriminimit.

<sup>2</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 22/09


Në periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 2012, janë regjistruar gjithsej 602 lëndë të reja. Kur këtë numër e krahasojmë me numrin e lëndëve nga dy vitet e mëparshme (viti 2010– 124 dhe 2011– 349), mund të konstatojmë shtimin e dukshëm të numrit të lëndëve. Ky shtim është rezultat i më shumë faktorëve – një numri të madh të aktiviteteve, aksioneve përruese dhe vizitave nëpër qytete dhe komuna në Serbi gjatë vitit 2012, pjesëmarrja në disa projekte në partneritet me organizatat e shoqërisë civile, si edhe ngritja e vetëdijes midis qytetarëve për mundësitë e mbrojtjes nga diskriminimi, gjë që i ka kontribuar shtimit të transparencës së institucionit të Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

**Grafikoni: Numri i lëndëve sipas viteve**



Nga numri i përgjithshëm i lëndëve të reja në vitin 2012, 465 janë ankesa, 117 rekomandime të masave për realizimin e barazisë, 6 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse, 5 padi, kurse të tjerat janë projekt-akte, nisma të legjislacionit, denoncime penale dhe propozimi i Gjykatës kushtetuese.

**Grafikoni: Numri i përgjithshëm i lëndëve**



### 1.1 Veprimi sipas ankesave

Një nga kompetencat themelore të Komesarit është **veprimi sipas ankesave në rastet e diskriminimit të personave ose grupit të personave të cilët i bashkon e njëjta veçori personale**<sup>3</sup>. Procedura sipas ankesave është e thjeshtë, është e liruar nga formalitetet e tepërta, plotësisht është falas dhe mund të zgjasë më së shumti 90 ditë<sup>4</sup>. Do t'i paraqesim hapat e tij themelorë:

#### Hapi 1. – Paraqitja e ankesës

Procedura para Komesarit për mbrojtjen e barazisë fillon me **paraqitjen e ankesës**. Ankesën mund ta paraqesë secili person fizik dhe juridik, si edhe organizatat të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe personat e tjerë<sup>5</sup>.

Ankesa duhet të përmbajë të dhënat për personin i cili është diskriminuar, kurse për atë që pohohet se ka bërë diskriminimin, përshkrimi i vetë aktit të

<sup>3</sup> Neni 33, LND

<sup>4</sup> Neni 35 dhe 39 i LND

<sup>5</sup> Neni 35, i LND

diskriminimit si edhe dëshmitë, përkatësisht, pohimet për dëshmi të cilat mund të përdoren për t'u dëshmuar vërtetësia e fakteve. Ankesa duhet të jetë e nënshkruar, dhe paraqitet me shkrim, në formë të shtypur, por mund të paraqitet edhe përmes telefaksit, postës elektronike me memorie të skanuar dhe me nënshkrim të paraqitësit, në formë elektronike bashkë me nënshkrim elektronik të paraqitësit, si edhe me gojë në procesverbal. Komesari për mbrojtjen e barazisë nuk vepron në bazë të ankesave anonime.

## Hapi 2. – Ekzaminimi për plotësimin e kushteve për veprim

Pas marrjes së ankesës së pari ekzaminohet se ankesa a i përmban të gjitha elementet e domosdoshme që të mund të veprohet në bazë të saj<sup>6</sup>. Nëse ankesa është e paplotë, e paqartë ose përmban mangësi të cilat e bëjnë të pamundur të veprohet, paraqitësit i dërgohet kërkesa që të mënjanojë mangësitë.

Nëse paraqitësi i ankesës në afatin e lënë nuk i mënjanon mangësitë, ankesa refuzohet. Ankesa mund të refuzohet edhe kur Komesari konstaton se nuk është kompetent të vendosë për shkeljen e theksuar të të drejtave, për të cilin rast e njohton paraqitësin e kërkesës për organin i cili është kompetent të ofrojë mbrojtjen juridike.

Komesari **nuk vepron** sipas ankesës<sup>7</sup>:

- nëse procedura para gjykatës për të njëjtën gjë tashmë nuk ka filluar ose nuk e ka marrë formën e prerë;
- nëse është e qartë se nuk ka shkelje të të drejtave për të cilat pohon paraqitësi,
- nëse për të njëjtën gjë tashmë është vepruar dhe për të cilën nuk janë ofruar dëshmi të reja,
- nëse konstaton se për shkak të kalimit të kohës nga momenti kur është bërë shkelja e të drejtave edhe nëse veprohet nuk mund të arrihet qëllimi.

## Hapi 3. – Konstatimi i gjendjes faktike

Nëse mund të veprohet sipas ankesës, në procedurën e mëtejme konstatohet gjendja faktike në bazë të të gjitha dëshmive në disponim<sup>8</sup> dhe bëhet analiza e tërësishme juridike e rastit.

<sup>6</sup> Në pajtim me Ligjin për ndalimin e diskriminimit dhe Rregulloren e punës me të cilën më hollësisht është rregulluar procedura para Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

<sup>7</sup> Neni 37, i LND

<sup>8</sup> Neni 37 i LND

#### Hapi 4. – Marrja e mendimit

Pas procedurës së zbatuar, Komesari e **merr vendimin në formë të mendimit** – për këtë se është bërë diskriminimi<sup>9</sup>. Bashkë me mendim se është bërë diskriminimi Komesari për mbrojtjen e barazisë ia lëshon edhe rekomandimin personit kundër të cilit është paraqitur ankesa. **Rekomandimi** ka të bëjë me mënyrat e mënjanimi të shkeljes së të drejtës, përkatësisht, mënyrat e mënjanimi të sjelljes diskriminuese ose trajtimit jo të barabartë<sup>10</sup>. Pas marrjes së rekomandimit, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa e ka afatin 30 ditë nga dita e marrjes të veprimi sipas rekomandimit dhe të mënjanojë shkeljen e të drejtave dhe ka për detyrë të veprimi sipas rekomandimit, si edhe për faktin që ta njoftojë Komesarin. Nëse kjo nuk ndodhë, Komesari është i autorizuar të marrë vendimin me të cilin diskriminuesit i shqiptohet masa e vërejtjes dhe i lihet afati i ri prej 30 ditësh që të mënjanojë shkeljen e të drejtës. Aktvendimi është definitiv dhe kundër tij nuk lejohet ankesë. Nëse brenda afatit të ri prej 30 ditësh diskriminuesi nuk e mënjanon shkeljen e të drejtës, Komesari për mbrojtjen e barazisë për këtë e njohton opinionin<sup>11</sup>.

Gjatë vitit 2012, janë paraqitur **465 ankesa**, gjë që dëshmon për shtimin e dukshëm të numrit të ankesave në krahasim me vitin e mëparshëm.

në vitin 2010	124 ankesa
në vitin 2011	349 ankesa
në vitin 2012	465 ankesa

Nga ana tjetër, numri i ankesave ende është shumë i vogël duke e marrë parasysh shkallën e përhapjes së diskriminimit në Serbi. Shkaqet për këtë janë të numërta: niveli i ulët i njohurive të qytetarëve për diskriminim, qëndrimet e tyre dhe perceptimi i diskriminimit, si edhe transparenca dhe mundësia e pamjaftueshme e Komesarit që të arrijë në tërë territorin e Serbisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2012 në punishte, seminare dhe tribuna të shumta në mbarë Serbinë të punësuarit në shërbim profesional të Komesarit kanë mësuar nga bisedat me qytetarë se shumica prej tyre kanë frikë nga viktimizimi të cilit mund t'i nënshtrohen pas paraqitjes së rastit të diskriminimit dhe që nuk kanë besim në institucionet të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave.

Gjatë vitit 2012, **numrin më të madh të ankesave e kanë paraqitur personat fizikë** – gjithsej 381 ankesa (81,4%). Personat juridikë i kanë paraqitur 81


<sup>9</sup> Neni 39, paragrafi 1, i LND

<sup>10</sup> Neni 39, paragrafi 2, i LND

<sup>11</sup> Neni 40, i LND

ankesa (17,3%), grupet e personave i kanë paraqitur 4 ankesa (0,9%) dhe organet shtetërore 2 (0,4%). Në grupin e personave juridikë, të parat janë organizatat e shoqërisë civile me 62 ankesa të paraqitura (13,2%).

**Grafikoni: Paraqitësit e ankesave**




Nga numri i përgjithshëm i ankesave të cilat i kanë paraqitur personat fizikë, gratë i kanë paraqitur 157 ankesa (41,2%), kurse meshkujt 222 (58,3%), kurse për dy ankesa të cilat janë paraqitur nuk dihet gjinia e paraqitësit (0,5%).

Në vitin 2012, 76 ankesa kanë të bëjnë me diskriminim në bazë të invaliditetit, pastaj 68 në bazë të përkatësisë kombëtare ose origjinës etnike, në bazë të gjinisë 42 ankesa, 32 bindjet fetare dhe politike, në bazë të grup-moshës 31 ankesa, 26 në bazë të anëtarësimit në organizata politike, sindikale dhe organizata të tjera, 22 në bazë të statusit martesor dhe familjar, 22 në bazë të gjendjes pronësore, 18 në bazë të gjendjes shëndetësore, 8 në bazë të orientimit seksual. Pa e theksuar bazën e diskriminimit kanë arritur 145 ankesa.



### Grafikoni: Baza e diskriminimit




Në vitin e mëparshëm kanë arritur 145 ankesa në të cilat nuk është theksuar veçoria personale dhe në të cilat paraqitësit e ankesave kryesisht i theksojnë disa nga shkeljet e të drejtave dhe/ose për veprimet jo të barabarta të cilat nuk bazohen në veçori personale të paraqitësve. Kjo e dhënë dëshmon për faktin se qytetarët në Serbi ende gjithnjë nuk kanë mjaft njohuri me nocionin e diskriminimit, dhe që shumë shpesh mendojnë se janë të diskriminuar edhe në situatën kur sjellja ose akti të cilin e theksojnë nuk ka të bëjë me kurfarë veçorie personale.

Në 433 ankesa është theksuar një veçori personale si bazë e ankesës, kurse në 32 ankesa, si bazë, janë theksuar disa veçori personale.

Edhe gjatë vitit të kaluar më së shumti ankesa janë paraqitur kundër organeve shtetërore – 228 (43,8%), pastaj kundër personave juridikë 132 (25,4%), kundër personave fizikë 125 (24%) dhe kundër organeve dhe instituconeve 25 ankesa. Në 421 ankesa është theksuar një person si diskriminues, kurse në 44 ankesa janë theksuar më shumë persona.

**Grafikon: Kundër kujt janë paraqitur ankesat**



Numri më i madh i ankesave edhe më tutje arrin nga personat me vendbanim/vendqëndrim, përkatësisht, me seli në Beograd dhe në lagjet periferike rreth Beogradit (38%), pastaj vijon rajoni i Vojvodinës (20,5%). Ky është tregues se institucioni i Komesarit për mbrojtjen e barazisë edhe më tutje është transparent më së shumti në Beograd dhe në rrethinë, kështu që edhe në vitin 2013 do të vazhdojnë aktivitetet me qëllim që të mund të arrihet deri te ky institucion, që të jetë më i kontaktueshëm, më i dallueshëm dhe më transparent.

Në vitin 2012, kanë qenë gjithsej **249 ankesa sipas të cilave nuk është vepruar**, dhe këtë për këto shkaqe: ka qenë e qartë se nuk ka shkelje të të drejtave të cilën e thekson paraqitësi i ankesës (199), ka filluar ose ka përfunduar procedura gjyqësore (38), por është vepruar, por nuk janë ofruar dëshmi të reja (11) dhe për shkak të kalimit të kohës nuk ka qenë e mundur të arrihet qëllimi i veprimit (1).

Shembull:


*Paraqitësi i ankesës pohon se gjatë vitit 2009, eprori i drejtpërdrejtë në punë, e ka ofenduar në bazë të përkatësisë kombëtare, statusit martesor dhe familjar dhe gjendjes shëndetësore. Ky është rast që për shkak të kalimit të kohës nga momenti kur është bërë shkelja e të drejtës nuk mund të arrihet qëllimi i veprimit.*

Shkak për mosveprim në numër më të madh të lëndëve është mungesa e veçorisë personale ose qartë mosnjohja e lidhjes së shkakut dhe pasojës midis veçorisë personale dhe aktit i cili theksohet si akt i diskriminimit.


Shembuj:

- Prindërit e nxënësit të një paraleleje të shkollës fillore e kanë paraqitur ankesën sepse fëmijëve të tyre u është ndërruar mësuësja, kështu që kanë konsideruar se fëmijët janë të diskriminuar me këtë.
- Paraqitësi i ankesës konsideron se është diskriminuar sepse nëntë muaj nuk është ndërmarrë kurrfarë veprimi në procedurë gjyqësore, e cila është duke u zhvilluar kundër tij.
- Paraqitësi i ankesës konsideron që është diskriminuar për shkak se është serb, sepse i vijnë llogaritë për shërbime komunale me alfabet latin.

**Grafikoni: Ankesat sipas të cilave nuk është vepruar**



Në bazë të 216 ankesave ka filluar procedura, nga të cilat 160 ankesa janë refuzuar, në 29 procedura është marrë vendimi se nuk ka pasur diskriminim, kurse në 27 raste është konfirmuar diskriminimi dhe është marrë rekomandimi përkatës.

**Grafikoni: Ankesat sipas të cilave është vepruar**

Nga numri i përgjithshëm i rekomandimeve në vitin 2012, në shumicën e rasteve është vepruar sipas rekomandimit, ndërsa në 6 lëndë diskriminuesit nuk kanë vepruar sipas rekomandimeve të Komesarit për mbrojtje të barazisë.

**1.2 Proceset gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi**

Komesari për mbrojtjen e barazisë mund të fillojë procese antidiskriminuese<sup>12</sup>, me ç'rast vetë e vlerëson nevojën për ngritjen e padisë. Nëse viktimi e diskriminimit është individ, Komesarit për mbrojtjen e barazisë i është i domosdoshëm pëlqimi i personit të diskriminuar, kurse në rastet e diskriminimit të grupit të personave që kanë të bëjnë me të njëjtën veçori personale nuk i është i domosdoshëm pëlqimi i personave të diskriminuar.

**Komesari me padi mund të kërkojë:**

- që gjykata të konstatojë se i padituri ka vepruar në mënyrë diskriminuese ndaj një personi të caktuar;
- ndalimin e kryerjes së veprimit nga i cili ekziston rreziku nga diskriminimi, ndalimin e kryerjes së mëtejme të veprimit të diskriminimit, përkatësisht, ndalimin e përsëritjes së diskriminimit;
- që diskriminuesi të ndërmarrë një ose më shumë veprime me të cilat e mënjanon gjendjen e diskriminimit;

<sup>12</sup> Neni 33 i LND

- që diskriminuesi me shpenzime të veta të shpallë aktgjykim gjyqësor me të cilin është konstatuar diskriminimi.

Komesari në padi **nuk mund të kërkojë** kompensimin e dëmit material ose jomaterial.

**Duhet pasur parasysh se ngritja e padisë nuk është mekanizëm me të cilin sigurohet zbatimi i rekomandimeve të Komesarit, as nuk është pjesë e procedurës sipas ankesave. Në secilin rast ekzaminohet a është objekt me rëndësi strategjike, dhe vetëm pas vlerësimit se është e nevojshme të zhvillohet i ashtuquajti “proces strategjik”, i paraqitet padia gjykatës kompetente.**

**Gjatë viti 2011 janë paraqitur tri padi për ruajtjen nga diskriminimi, kurse në vitin 2012 edhe pesë.** Tri procedura e kanë marrë formën e prerë në momentin e hartimi të këtij raporti.

- Padia për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë pakicës kombëtare rome kundër Vasa Keniçit nga Svërligu;
- Padia e dytë për shkak të diskriminimit në bazë të pakicës kombëtare rome është paraqitur kundër restorantit të ushqimit të shpejtë “M.D:” sepse punëtori i sigurimit nuk ua ka lejuar fëmijëve me kombësi rome që të hyjnë në restorant me një grua e cila ka dashur t’u blejë ushqim në restorant.
- Padia për shkak të diskriminimit në bazë të lindjes dhe të statusi martesor dhe familjar kundër qytetit të Jagodinës, për shkak të Vendimit për ndihmën financiare çifteve bashkëshortore nr. 011-92/10-10-1, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Qytetit të Jagodinës, më 23 dhjetor të vitit 2010. Padia e parë për shkak të diskriminimit në bazë të gjinisë është paraqitur kundër Lidhjes Fudbollistike të Serbisë, për shkak të diskriminimit të klubeve fudbollistike për femra në krahasim me klubet fudbollistike për meshkuj, në bazë të gjinisë së lojtarëve/eve.
- Padia e dytë për shkak të diskriminimit në bazë të gjinisë është paraqitur kundër një banke për shkak të zhvendosjes së një gruaje të punësuar në vend më të ulët të punës pas kthimit të saj nga leja e shtatzanisë dhe mungesës në punë për shkak të kujdesit për fëmijën e tretë.
- Padia e tretë për shkak të diskriminimit në bazë të gjinisë është paraqitur kundër zinxhirit të picerive të cilat i punësojnë vetëm femrat.
- Padia për shkak të diskriminimit në bazë të dënimit penal, gjinisë, statusit martesor dhe familjar, gjendjes shëndetësore është paraqitur kundër shoqërisë ekonomike „K.i.“ e cila në prezantimin e vet në internet e ka publikuar pyetësorin për punësim në të cilin nga kandidatët dhe kandidatet të cilat konkurrojnë për punë kërkohen të dhënat që kanë të bëjnë me veçoritë e tyre personale, dhe këtë: statusit martesor ose familjar, gjendjes shëndetësore, si edhe dënimi penal. Padia është paraqitur,

më datën 20 korrik të vitit 2012 dhe procedura e shkallës së parë është në zhvillim e sipër.

- Padia për diskriminim në bazë të invaliditetit është paraqitur më 2 tetor të vitit 2012 kundër sipërmarrësit M.A, pronar i dyqanit „P. C.“, sepse të punësuarit në këtë shërbim restoranti kanë refuzuar t’i ofrojnë shërbim një grupi të personave të rinj me invaliditet.

Është e nevojshme të theksohen disa probleme në të cilat kemi hasur lidhur me këto veprime. Edhe pse me dispozitën e nenit 41, paragrafi 3, i Ligjit për ndalimin e diskriminimit është parashikuar që procedura për mbrojtjen nga diskriminimi është urgjente, në asnjë rast parimi i urgjencës nuk është respektuar. Gjithashtu, shumë shpesh lëndët regjistrohen si mosmarrëveshje pune, kurse në një rast lënda ka qëndruar e paregjistruar një periudhë të gjatë kohore. Komesarit disa herë i është dërguar urdhri për të paguar taksat gjyqësore, edhe pse Komesari si organ shtetëror, është i liruar nga pagimi i taksave, në pajtim me dispozitën e nenit 9, paragrafi 1, i Ligjit për taksat gjyqësore<sup>13</sup>.

### 1.3 Procedurat kundërvajtëse

Komesari për mbrojtjen e barazisë është i autorizuar të paraqesë denoncime kundërvajtëse për shkak të shkeljes së të drejtave nga *Ligji për ndalimin e diskriminimit*<sup>14</sup>. Duke e marrë parasysh rolin e vet, Komesari është i autorizuar edhe të paraqesë denoncime kundërvajtëse në pajtim me ligjet e veçanta antidiskriminuese: *Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të pakicave kombëtare*, *Ligjin për parandalimin e diskriminimit të personave me invaliditet*, *Ligjin për barazi gjinore*, si edhe me dispozita të tjera.

Në vitin 2012 Komesari për mbrojtjen e barazisë i ka paraqitur **6 kërkesa për fillimin e procedurave kundërvajtëse**.

Në bazë të disa procedurave të filluara, mund të konstatojmë se gjykatat kundërvajtëse në Serbi gjatë vitit 2012 pa nxituar kanë vepruar sipas kërkesave për fillimin e procedurave kundërvajtëse të cilat i ka paraqitur Komesari për mbrojtjen e barazisë.

---

<sup>13</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 28/94, 53/95, 16/97, 34/2001 – ligji tjetër 9/2002, 29/2008, 61/2005, 116/2008 – ligji tjetër, 31/2009 dhe 101/2011).

<sup>14</sup> Neni 33, pika 4, e LND

Mund të konstatohet se ekziston një moskuptim i përgjithshëm për vetë brendinë e diskriminimit dhe autorizimet e Komesarit për mbrojtjen e barazisë në procedurat kundërvajtëse. Një situatë e këtillë me siguri është pasojë e faktit se Komesari për mbrojtjen e barazisë është organ relativisht i ri shtetëror i cili vepron në bazë të ligjeve specifike, me të cilat gjykatësit e gjykatave kundërvajtëse nuk kanë pasur deri më tani shumë përvojë praktike. Në këtë kuptim, Komesari për mbrojtjen nga barazia do të punojë për shtimin e transparencës, por do të ndërmarrë edhe një sërë hapash që gjykatësit e gjykatave kundërvajtëse do të informohen për kompetencat e Komesarit, për vetë dukurinë e diskriminimit, për veçoritë e kundërvajtjeve kundërdiskriminuese, si edhe për rëndësinë e zhvillimit të azhurnuar të këtyre procedurave dhe të dënimit adekuat të autorëve.

## 1.4 Denoncimi penal

Komesari për mbrojtjen e barazisë në vitin 2012 ia ka paraqitur denoncimin penal Prokurorisë së Lartë Publike në Beograd kundër NN personave, autorit të tekstit “Plaçkitja e Serbisë dhe e popullit serb si ndihmë romëve” i publikuar në blogun e romëve në Serbi [www.romiusrbiji.wordpress.com](http://www.romiusrbiji.wordpress.com). Denoncimi është paraqitur për shkak se ka ekzistuar dyshimi se kryerësi i panjohur ka bërë veprë penale të nxitjes së urrejtjes dhe intolerancës kombëtare, të racës dhe fetare nga neni 317, paragrafi 1, i Kodit Penal të RS.

## 1.5 Rekomandimet organeve të pushtetit publik

Komesari për mbrojtjen e barazisë ka autorizime t’u rekomandojë organeve të pushtetit dhe personave të tjerë **masat për realizimin e barazisë**<sup>15</sup>. Rekomandimet mund të orientohen në atë drejtim që organet e pushtetit publik të ndërmarrin masa për të parandaluar dhe mënjanuar diskriminimin institucional dhe për të përparuar punën e institucioneve të sistemit për zhdukjen e diskriminimit. Me rekomandimet theksohen edhe nevojat e ndërmarrjes së masave të veçanta, të të ashtuquajturat masat e veprimit afirmativ, të cilat duhet të sjellin deri te barazia e plotë, mbrojtja dhe përparimi i personave ose i grupeve të cilat gjenden në pozitë jo të barabartë në krahasim me qytetarët e tjerë.

Pasqyrën e rekomandimeve e japim në pjesët e raportit që kanë të bëjnë me bazat individuale të diskriminimit (Kaptina 3).

<sup>15</sup> Neni 33, pika 9, e LND

*Rekomandimi të gjitha gjykatave me kompetenca të përgjithshme (14 qershor 2012.)*

Të gjitha gjykatave me kompetencë të përgjithshme në Republikën e Serbisë u është dërguar rekomandimi që të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme, në pajtim me autorizimet ligjore, me të cilat do të sigurohet që veprimet në proceset gjyqësore diskriminuese, të cilat zhvillohen në bazë të dispozitave të Ligjit për ndalimin e diskriminimit dhe të dispozitave të tjera antidiskriminuese, zbatohen në mënyrë ekspeditive dhe të përfundojnë brenda afatit sa më të shkurtër të mundur, në pajtim me nenin 41, paragrafi 3, i Ligjit për ndalimin e diskriminimit me të cilin është përcaktuar se kjo procedurë është urgjente.

## 1.6 Nismat e legjislacionet dhe mendimet për dispozitat

Komesari për mbrojtjen e barazisë, gjithashtu, është i autorizuar të monitorojë zbatimin e ligjit dhe të akteve të tjera, të fillojë miratimin ose ndryshimin e dispozitave për të përparuar mbrojtja nga diskriminimi. Gjithashtu, Komesari ka autorizim të japë mendimin për dispozitat e projektligjit dhe të akteve të tjera të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit<sup>16</sup>.

Në vitin 2012, Komesarja ua ka dhënë tri mendime organeve kompetente për versionet e punës së ligjit dhe një nismë të legjislacionit<sup>17</sup>.

- Nisma Qeverisë së Republikës së Serbisë për ndryshimin e Vendimit për arsim të Fondit për talentë të rinj ("Fletorja zyrtare e RS", nr. 71/08, 44/09, 37/11) me të cilin janë përcaktuar kushtet për dhënien e bursës studentëve më të mirë të shkallës së dytë dhe të tretë në universitetet e huaja (28 maj të vitit 2012).

- Mendimi për disa dispozita të Versionit punues të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për procedurën jashtëgjyqësore lidhur me procedurën e heqjes së aftësisë për punë (5 nëntor të vitit 2012).

- Mendimi për dispozitat e nenit 55a – 55gj të Versionit punues të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për procedurë jashtëgjyqësore me të cilat rregullohet procedura e re e cila ka të bëjë me lejen për ndryshim juridik të gjinisë dhe të identitetit gjinor (5 nëntor të vitit 2012)

- Mendimi për Versionin punues të Projektligjit për ndërmjetësim dhe nevoja për ndryshimin e pjesëve të Projektligjit (5 nëntor të vitit 2012).

<sup>16</sup> Neni 33, pika 7 e LND

<sup>17</sup> Hollësitrat dhe mendimet konkrete të Komesarit për mbrojtjen e barazisë dhe nismat e legjislacionit gjenden në Raportin e rregullt vjetor për vitin 2012. Në Raportin e shkurtuar po e japim vetëm pasqyrën e përgjithshme të nismave të legjislacionit.



## 1.7 Paralajmërimet dhe kumtesat e opinionit

Komesari është i autorizuar të paralajmërojë opinionin për rastet më të shpeshta, tipike dhe të rënda të diskriminimit<sup>18</sup>. Komesari këtë e bën në bazë të informatave dhe njohurive nga ankesat e paraqitura, mjetet e opinionit publik dhe nga burimet e tjera. Në paralajmërim të opinionit Komesari dëshmon për diskriminuesit, mënyrën e kryerjes së diskriminimit, individët dhe grupet ndaj të cilave janë bërë format më të shpeshta, tipike dhe të rënda të diskriminimit, si edhe pasojat e formave të rënda të diskriminimit.

Gjatë vitit 2012 janë lëshuar dy paralajmërimet dhe 17 kumtesa për opinion, të cilat janë publikuar në media dhe në web faqe të Komesarit Poverenika [www.ravnopravnost.gov.rs](http://www.ravnopravnost.gov.rs).

## 1.8 Vendosja e sistemit të shërbimeve të ndërmjetësimit në kuadër të shërbimit të Komesarit

Komesari për mbrojtje të barazisë është autorizuar që palëve t'u propozojë zbatimin e procedurës së pajtimit, përkatësisht ndërmjetësimit. Duke i pasur parasysh përvojat pozitive krahasuese dhe përparësitë e ndërmjetësimit, Komesari e ka filluar punën për vendosjen e sistemit të shërbimeve të ndërmjetësimit në kuadër të shërbimit të Komesarit.

Procedura e ndërmjetësimit është e besueshme, proces i strukturuar në të cilin pala e tretë neutrale, ndërmjetësuesi, e orienton dialogun midis personave në konflikt kështu që ata mund ta shqyrtojnë problemin në një mënyrë të re dhe të arrihet rezultati i cili është i pranueshëm për të gjithë.

Vetë Ligji për ndalimin e diskriminimit nuk e rregullon procedurën e ndërmjetësimit në rastet e diskriminimit, tashmë dërgohet për aplikimin e dispozitave të përgjithshme me të cilat rregullohet ndërmjetësimi. Dispozitat për ndërmjetësim përmbahen në Ligjin për ndërmjetësim – ndërmjetësimin e Republikës së Serbisë nga viti 2005<sup>19</sup>. Me këtë ligj janë konfirmuar parimet themelore të procedurës së ndërmjetësimit, mënyra e fillimit dhe zbatimit të ndërmjetësimit, autorizimet e palëve, detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesit, si edhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë ndërmjetësuesit që të mund të bëjnë ndërmjetësimin. Me Rregulloren e punës së Komesarit janë përcaktuar rregullat për mënyrën e veprimit të të punësuarëve në shërbim të Komesarit me qëllim të dallimit të rasteve të përshtatshme për ndërmjetësim dhe mënyra e komunikimit me palët (neni 27, i Rregullores së punës).

<sup>18</sup> Neni 33, pika 6, e LND

<sup>19</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, 18/2005.

Në periudhën e deritashme të aktiviteteve të Komesarit për mbrojtje të barazisë për vendosjen e sistemit të shërbimeve të ndërmjetësimit në rastet e diskriminimit janë zhvilluar në katër drejtime: 1) krijimi i modelit të veçantë të ndërmjetësimit në rastet e diskriminimit, 2) krijimi dhe realizimi i programit të trajnimit të ndërmjetësuesve të specializuar, 3) trajnimi i të punësuarëve në shërbim të Komesarit dhe 4) përrurimi i ndërmjetësimit.

Komesari për mbrojtjen e barazisë e ka formuar Grupin punues i cili e ka hartuar modelin e ndërmjetësimit të përshtatur me karakteristikat e situatës e cila krijohet me bërjen e diskriminimit. Disa veçori të modelit i cili zbatohet në kuadër të shërbimit të Komesarit:

- modeli i veçantë i ndërmjetësimit i bazuar në parimet standarde të ndërmjetësimit: në vullnet, besueshmëri, joanshmëri dhe neutralitet.
- janë krijuar elementet e ndërmjetësimit midis viktimës dhe autorit /kryerësit (Victim - offender Mediation), të cilat janë bazuar në konceptin e të drejtës restorative, meqenëse ndërmjetësimi standard nuk u është përshtatur situatave të diskriminimit sepse është destinuar për zgjidhjen e konfliktit, kurse te diskriminimi në shumicën e rasteve në mesin e palëve nuk ekziston konflikt, por bëhet fjalë për shkelje emotive ose tjetër të cilën njëra palë ia ka bërë palës tjetër.
- rregulla specifike për kriteret dhe për mënyrën e zgjedhjes së lëndëve të përshtatshme për ndërmjetësim<sup>20</sup>.
- parimi i ripërkufizuar i neutralitetit në këtë vështrim që nuk mund të jetë moralisht neutral ndaj diskriminimit, por duhet krejtësisht qartë të demonstron se kjo moralisht është e papranueshme.
- shërbimi i Komesarit u ofron palëve informata gjithnjë e më relevante për procedurën e ndërmjetësimit dhe procedurën standarde sipas ankesave, me çfarë palëve u ofrohet mundësia të shqyrtojnë përparësitë e secilës procedure dhe të zgjedhet ai i cili i përmbushë intereset e tyre.

Komesari është autorizuar të emërojë ndërmjetësuesit dhe t'i regjistrojë në *Listë të ndërmjetësuesve të autorizuar*, me ç'rast është autorizuar të konstatojë kriteret dhe kushtet më të hollësishme të cilat duhet t'i plotësojnë ndërmjetësuesit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndërmjetësim – ndërmjetësimi. Duke e pasur parasysh organizimin e punës së shërbimit të Komesarit dhe mënyrën e punës sipas ankesave, si edhe nevojën që të mënjanohet çdo dyshim në neutralitet dhe njëanshmëri të ndërmjetësuesit dhe me këtë maksimalisht të mbrohet integriteti i vetë ndërmjetësimit, në Listë të ndërmjetësuesve të Komesarit mund të jenë ve-

---

<sup>20</sup> Janë caktuar rregullat e veçanta të cilat e përjashtojnë aplikimin e ndërmjetësimit në rastet në të cilat rast për paraqitjen e ankesës për shkak të sjelljes diskriminuese që është bazuar në ndonjë akt të përgjithshëm të organit të pushtetit publik ose personit juridik. Nga ana tjetër, ekzistojnë kriteret për vlerësimin e aplikueshmërisë së ndërmjetësimit që kanë të bëjnë me vetë palët në procedurë.

tëm personat të cilët nuk janë punësuar në shërbim të Komesarit, e të cilët i plotësojnë kriteret dhe kushtet më të hollësishme të cilat i ka caktuar Komesari.

Gjatë vitit 2012, ka përfunduar cikli i parë i trajnimit për ndërmjetësues, të cilët me sukses e kanë përfunduar 22 persona<sup>21</sup>, kurse trajnimi i specializuar është planifikuar për tremujorin e parë të vitit 2012 dhe pas përfundimit të tij do të bëhet regjistrimi i ndërmjetësuesve në Listën e ndërmjetësuesve të autorizuar të Komesarit. Trajnimi i të punësuarëve në shërbim të Komesarit është realizuar dy herë, përmes ligjëratave dhe punishteve, kurse e kanë përgatitur dhe e kanë realizuar anëtarët e Grupit punues i cili e ka krijuar një model të veçantë të ndërmjetësimit. Radhën e ka realizimi i trajnimit të nivelit të përparuar.

Në periudhën e deritashme aktivitetet kryesore në përirim dhe ndërmjetësim në rastet e diskriminimit janë zhvilluar në kuadër të projektit “Partneriteti për tolerancë dhe mbrojtja nga diskriminimi në Serbi”, të cilin bashkërisht po e zbatojnë Parnterët për ndryshime demokratike Serbia dhe Qendra për zgjidhje alternative të konfliktit. Në kuadër të këtij projekti është organizuar edhe një sërë panel diskutimesh, punishtesh, trajnimit, konferencave dhe aktiviteteve të tjera në mbi 15 qytete në Serbi, në të cilat kanë marrë pjesë edhe të punësuarit në shërbim të Komesarit.

Gjatë vitit 2012, procedura e pajtimit (ndërmjetësimit) është ofruar në gjithsej shtatë lëndë, dhe në të gjitha lëndët propozimi për pajtim nuk është pranuar.

---

<sup>21</sup> Në pajtim me kushtet nga ftesa publike e cila është publikuar në fund të tetorit të vitit 2012, me rastin e zgjedhjes së kandidatëve/kandidateve është pasur kujdes për përfaqësimin e barabartë rajonal, me ç'rast përparësi u është dhënë kandidatëve dhe kandidateve nga grupet e marginalizuara shoqërore. Gjatë trajnimit pesëditor në tetor të vitit 2012, pjesëmarrësit kanë pasur rastin të fitojnë njohuri dhe shkathtësi plotësuese të komunikimit për zhvillimin e ndërmjetësimit dhe për çështjet etnike.

Shembuj:

- Paraqitësja e ankesës ka theksuar se fqinja D.P. shumë herë e ka ofenduar në mënyrë verbale në bazë kombëtare, me këtë përmbajtje: „Ti je shiftare e mjerë, e verbër, nuk do të lejoj të zgjerohesh, ti po të vleve, nuk do të jetoje në kasolle”. Ka theksuar se D.P. po i nxit edhe personat tjerë kundër saj dhe familjes së saj për shkak të përkatësisë së pakicës kombëtare shqiptare.

- Paraqitësi i kërkesës ka qenë një anëtar i kuvendit në legjislaturën e vitit 2008 deri 2012, i komunës I., dhe pohon se komuna nuk po ia paguan të ardhurat shtesë që i kanë mbetur si anëtar i këshillit të cilat ua paguan anëtarëve të ri të këshillave në kuvend. Konsideron se me një sjellje të këtillë ëshë diskriminuar në bazë të anëtarësisë në organizatë politike.

## 2. Shërbimi profesional dhe zhvillimi i institucionit të Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative nga fushëveprimi i punës së Komesarit, është formuar shërbimi profesional i cili Komesarit i ndihmon në kryerjen e kompetencave të tij.

Me Rregullohen për rregullimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbim profesional të Komesarit janë sistematizuar gjithsej 60 të punësuar, katër në pozitë, 53 në vende pune për zbatim dhe tri vende pune për nëpunës. Nga numri i parashikuar janë plotësuar gjithsej 19 vende të punës duke përfshirë edhe Komesaren për mbrojtjen e barazisë. Duke e marrë parasysh vëllimin e punës, numri ekzistues i të punësuarëve nuk paraqet numër optimal për punë të azhurnuar dhe cilësore të këtij organi të pavarur. Edhe pse ekziston nevoja për shtimin e numrit të të punësuarëve, duke e marrë parasysh shtimin e vëllimit të punës dhe numrin e aktiviteteve të cilat Komesari i zbaton, kjo për momentin nuk është e mundur për shkak të ambienteve joadekuate për zyra që i është dhënë në shfrytëzim Komesarit në fund të vitit 2010. Për këtë arsye Komesari edhe në vitin e kaluar ka qenë i detyruar që nevojën për numër më të madh të të punësuarëve ta tejkalojë me angazhimin e kohëpaskohshëm të personave në bazë të kontratave përkatëse.

Me qëllim të kryerjes më efikase dhe më të efektshme të kompetencave të dhëna me ligj nga fushëveprimi i punës së Komesarit, dhe në bazë të përvojës dyvjeçare dhe praktikës së punës së shërbimit, në shkurt të vitit 2012, është propozuar ndryshimi i sistematizimit, të cilin në nëntor të vitit 2012 e ka lejuar Kuvendi Popullor<sup>22</sup>. Me Rregullore<sup>23</sup> nuk është parashikuar shtimi i numrit të vendeve të sistematizuara të punës, as për zbatimin e saj nuk është e nevojshme të ndahen mjete plotësuese të buxhetit.

Gjatë vitit 2012 janë intensifikuar aktivitetet me qëllim të ngritjes së nivelit të njohurive të përgjithshme dhe specifike dhe të kompetencave profesionale të të punësuarëve në shërbim profesional të Komesarit. Për të punësuar në shërbim profesional gjatë vitit 2012 janë organizuar disa trajnime, seminare dhe punishte, në të cilat ligjëruesit kanë qenë ekspertë prestigjiozë dhe me përvojë nga institucionet akademike dhe organizatat e shoqërisë civile.

---

<sup>22</sup> Vendimi për dhënien e e pëlqimit lidhur me Vendimin për ndryshimin e Vendimit për formimin dhe punën e shërbimit profesional të Komesarit për mbrojtjen e barazisë dhe Rregullores për rregullimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbim profesional të Komesarit për mbrojtjen e barazisë, "Fl. Zyrare e RS", nr. 111/12.

<sup>23</sup> Rregullorja për rregullimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbim të Komesarit gjendet në: <http://www.ravnopravnost.gov.rs/lat/opstiAktiPoverenika.php?idKat=1>

Gjatë vitit 2012 janë intensifikuar aktivitetet për ngritjen e nivelit të njohurive të përgjithshme dhe specifike dhe i kompetencave profesionale të të punësuarëve në shërbim profesional të Komesarit. Për të punësuarit në shërbim profesional gjatë vitit 2012 janë organizuar disa trajnime, seminare dhe punishte, në të cilat ligjëruesit kanë qenë ekspertë prestigjiozë dhe me përvojë nga institucionet akademike dhe organizatat e shoqërisë civile.

Me qëllim të shtimit të efikasitetit dhe të cilësisë së punës, janë përcaktuar procedurat dhe janë krijuar udhëzimet e domosdoshme për të punësuar në shërbim profesional. Me udhëzime janë vendosur procedurat dhe standardet e brendshme, dhe janë bërë bashkë me pjesëmarrjen e plotë të të punësuarëve, si edhe dokumentet e gjalla në të cilat mund të bëhen ndryshime.

Hapësira afariste të cilën e përdorë Komesari e ka sipërfaqen 248 m<sup>2</sup>, gjendet në ndërtesën në rrugën Beogradska nr. 70, në katin e parë, pa shërbim sigurimi dhe nuk i takon vendit për parkim për automjete zyrtare, gjë që e vështirëson punën e papenguar. Ambienti ekzistues për zyra i është dhënë Komesarit si zgjidhje e përkohshme, në bazë të përfundimit të Komisionit për ndarjen e ndërtesave zyrtare dhe ambienteve për zyra të Qeverisë së Republikës së Serbisë, 77 nr. 361-5713/2010 nga 9 shtatori i vitit 2010.

Ambienti për zyra është pajisur gjatë vitit 2011, kur është instaluar postblloku bashkues dhe platforma bashkëkohore –ngritës-lëshuese për persona me invaliditet. Gjatë vitit të kaluar janë ndërmarrë masa që institucioni i Komesarit të mund t'u shërbejë dhe ta shfrytëzojnë personat me invaliditet, prandaj kështu në salla për mbledhje edhe në zyra për pranim është vendosur pajisja për përforsimin e zërit e cila ua lehtëson komunikimin personave me dëgjim të dëmtuar. Gjithashtu janë instaluar sistemet e induksionit për amplifikimin e fjalimit, i cili ua bën të mundur personave të cilët bartin aparate të dëgjimit që të dëgjojnë më qartë personin me të cilin bisedojnë, përkatësisht zërat rreth vetes i dëgjojnë pa pengesa. Ambientet në të cilat është instaluar sistemi janë të shënuara me shenjë të dallueshme ndërkombëtare, që përdoruesit të aparatit të dëgjimit ia japin informatën se në këtë vend është vendosur altoparlanti në mënyrë të veçantë. Të gjithë të punësuarit në shërbim profesional të Komesarit i përdorin kartvizitat me alfabetin Braj, kurse gjatë vitit 2012, ka filluar të përgatitet edhe libri audio dhe botimi i përshtatur për persona me të parit e dëmtuar, i cili duhet të botohet shumë shpejt.

Ambienti i tërësishëm për punë i Komesarit është i pajisur me tabela taktile me alfabet Braj, me emërtim të institucionit, gjë që ua lehtëson personave me të parit e dëmtuar trajtimin dhe qëndrimin në ambientet e Komesarit.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Komesarit është dhënia e informatave qytetarëve për të drejtat e tyre dhe për mekanizmat e mbrojtjes juridike nga diskriminimi, duke përfshirë edhe informatat për mundësitë e zgjidhjes së qetë të rastit të diskriminimit. Gjithashtu, me ligj, është përshkruar mundësia që ankesat mund t'i paraqesin edhe me gojë në procesverbal, si edhe në procedurën

e konstatimit të gjendjes faktike shënohen në procesverbal edhe deklaratat e paraqitësve të ankesave dhe të personave të tjer. Për shkak të nevojës që të komunikohet drejtpërsëdrejti me qytetarë, gjatë vitit 2012 janë finalizuar aktivitetet për **hapjen e zyrës për pranim**.

Meqenëse nuk ka pasur kushte për punë dhe sigurim që puna e zyrës për pranim të organizohet në ambiente të punës, ku punojnë të punësuarit në shërbim profesional, me kërkesë të Komesarit është siguruar një zyrë si një zgjidhje kalimtare. Zyra për pranim e ka filluar punën në maj të vitit 2012, pasi që të punësuarit në shërbim profesional, me përkrahjen e OSBE-së, e kanë përfunduar trajnimin dhe i kanë fituar njohurit e nevojshme dhe shkathtësitë për të bërë intervistat juridike dhe këshillimet. Duke e marrë parasysh se puna e shërbimit profesional zhvillohet në dy vendndodhje, zyra për pranim funksionon sipas parimit të caktimit të mëparshëm të kohës me palë. Pranimi i palëve është organizuar të martën dhe të enjten, por sipas nevojë është e mundur të caktohet koha edhe gjatë ditëve të tjera të punës. Nga fillimi i punës zyret për pranim ndihmën juridike falas e kanë marrë në formë të informatave juridike dhe të këshillave juridike 66 palë, kurse mbi 1000 qytetarë kanë marrë informata me telefon.

Në bashkëpunim dhe me përkrahjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Komesari, gjatë vitit 2012 e ka krijuar web faqen e re të internetit, e cila në krahasim me të mëparshmen, jo vetëm që është pasuruar me përmbajtje të reja, tashmë është përparuar edhe në pikëpamje të asaj që përmbajtjet mund t'i marrin personat të cilët e kanë të dëmtuar edhe dëgjimin edhe të të parit.

Në maj të vitit 2012, ka përfunduar edhe puna në Strategjinë e zhvillimit të institucionit të Komesarit për mbrojtjen e barazisë<sup>24</sup>, bashkë me pjesëmarrjen aktive të të gjithë të punësuarëve në shërbim profesional. Strategjia është krijuar si rezultat i nevojës që të përkufizohet përparësia strategjike e punës së Komesarit për një periudhë trivjeçare (2012-2015), për të përparur veprimin e Komesarit dhe për realizimin me sukses të misionit të tij.

#### **VIZIONI**

**SERBIA ËSHTË SHOQËRI E HAPUR DHE TOLERANTE E NJERËZVE TË BARABARTË, E CILA TË GJITHËVE U OFRON MUNDËSI TË BARABARTA.**

---

<sup>24</sup> Strategjia e zhvillimit të institucionit të Komesarit për mbrojtjen e barazisë gjendet në: <http://www.ravnopravnost.gov.rs/lat.o>Nama.php>

**MISIONI**

**ÇRRËNJOSJA E TË TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT DHE  
REALIZIMI I BARAZISË SË PLOTË NË TË GJITHA FUSHAT E JETËS  
SHOQËRORE.**

Në Strategji janë përkufizuar këto përparësi strategjike: 1) zhdukja e efektshme dhe mbrojtja nga diskriminimi; 2) vetëdija e përparuar e opinionit për diskriminim; 3) transparenca dhe mundësia që të përdorin institucionin e Komesarit, dhe 4) shërbimi efikas dhe funksional i Komesarit. Në kuadër të secilës përparësie janë përkufizuar qëllimet strategjike dhe detyrat strategjike.



### 3. Gjendja për realizimin dhe mbrojtjen e barazisë dhe veprimi i Komesarit

Republika e Serbisë gjatë viteve të kaluara e ka krijuar kornizën e duhur juridike për zhdukjen e diskriminimit dhe realizimin e barazisë. Përveç miratimit të ligjeve antidiskriminuese, Republika e Serbisë i ka miratuar edhe marrëveshjet më të rëndësishme universale dhe rajonale në fushën e të drejtave të njeriut.

Me Kushtetutë të Republikës së Serbisë<sup>25</sup> është ndaluar secili diskriminim, jo i drejtpërdrejtë ose i drejtpërdrejtë, në bazë të çfarëdo baze, dhe sidomos në bazë të racës, gjinisë, përkatësisë kombëtare, origjinës shoqërore, lindjes, konfesionit, bindjes politike ose ndonjë bindjeje tjetër, gjendjes pronësore, kulturës, gjuhës, moshës dhe invaliditetit psikik ose fizik.

Janë miratuar ligjet e përgjithshme dhe të veçanta antidiskriminuese: Ligji për ndalimin e diskriminimit (2009)<sup>26</sup>, Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të pakicave kombëtare (2002)<sup>27</sup>, Ligji për parandalimin e diskriminimit të personave me invaliditet (2006)<sup>28</sup> i Ligjit për barazinë e gjinive (2009)<sup>29</sup>.

Ndalimi i diskriminimit është i pranishëm në ligje të shumta me të cilat rregullohen fushat e veçanta të marrëdhënieve shoqërore: Ligji për punë (2005)<sup>30</sup>, Ligji për riaftësim profesional dhe punësim të personave me invaliditet (2009)<sup>31</sup>, Ligji për mbrojtjen shëndetësore (2005)<sup>32</sup>, Ligji për bazat e sistemit të arsimit dhe edukimit (2009)<sup>33</sup>, Ligji për kishat dhe bashkësitë fetare (2006)<sup>34</sup>. Mbrojtja penalo-juridike nga diskriminimi është rregulluar me Kodin penal të Republikës së Serbisë<sup>35</sup>, i cili përcakton disa vepra penale lidhur me ndalimin e diskriminimit, siç janë shkelja e lirisë së shprehjes e përkatësisë kombëtare ose etnike, rrëfimit të besimit dhe kryerjes së ritualeve fetare, përrurimi dhe të bazuarit në urrejtje,

---

<sup>25</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 98/06, neni 21

<sup>26</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 22/09.

<sup>27</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 11/02, “Fletorja zyrtare e SMZ”, nr. 1/03 – Karta kushtetuese dhe “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 72/09 – ligji tjetër.

<sup>28</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 33/06.

<sup>29</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 104/09.

<sup>30</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 24/05, 61/05 dhe 54/09.

<sup>31</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 36/09.

<sup>32</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 107/05 dhe 72/09 – ligji tjetër

<sup>33</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 73/09.

<sup>34</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 36/06.

<sup>35</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 85/05, 88/05 – korrigji., 107/05 – korrigji., 72/09 dhe 111/09.

dhunë ndaj personit ose grupit të personave në bazë të ndonjë veçorie të tyre personale dhe etj.

Këto dispozita ofrojnë kornizë të mirë juridike për parandalimin dhe zhdjekjen e diskriminimit duke e përdorur mbrojtjen qytetaro-juridike, penalo-juridike dhe kundërvajtëse-juridike, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për përparim dhe plotësim të dispozitave të cilat janë relevante nga aspekti i realizimit dhe mbrojtjes së parimit të barazisë.

Edhe pse nuk ekzistojnë të dhënat e bashkuara për dukurinë e diskriminimit, është evidente se diskriminimi edhe më tutje është dukuri e përhapur në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Është e nevojshme të theksohet se një nga parakushtet e luftës efikase kundër diskriminimit është vendosja e mekanizmave për përcjelljen e dukurisë së diskriminimit, efekteve të aplikimit të instrumenteve ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, si edhe masave të veçanta të cilat nënkuptohen për realizimin e barazisë së disa grupave të marginalizuara dhe të ndjeshme shoqërore. Mirëpo, edhe përkundër rekomandimit të Komesarit që të vendoset sistemi unik dhe i centralizuar i grumbullimit dhe regjistrimit të të dhënave relevante për përcjelljen e dukurisë së diskriminimit dhe mënyrës së funksionimit të sistemit të mbrojtjes juridike nga diskriminimi, një system i këtillë nuk është vendosur, gjë që e vështirëson këqyrjen e gjendjes reale.

### **3.1 Raporti i qytetarëve ndaj diskriminimit – hulumtimi i opinionit publik**

Gjatë vitit 2012 Komesari, me përkrahjen dhe ndihmën e Programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim (UNDP), e ka organizuar hulumtimin e opinionit publik “Raporti i qytetarëve ndaj diskriminimit në Serbi”<sup>36</sup>, të cilin e ka zbatuar Qendra për zgjedhje të lira dhe demokraci (CeSID).

Rezultatet kryesore të hulumtimit kanë treguar se shumica e të anketuarëve konsideron se diskriminimi është mjaft ose shumë i pranishëm në Serbi. Inkurajon fakti se numri i atyre që mendojnë se diskriminimi fare nuk është i ndaluar është përgjysmuar në krahasim me vitin 2010. Gjithashtu, është shtuar numri i atyre të cilët besojnë se ekzistojnë pasojat e qarta për ata të cilët e zbatojnë diskriminimin, por përqindja edhe më tutje është e vogël – gjithsej 16% të anketuar. Brengosin të dhëna se madje një e treta e qytetarëve e ka theksuar se

<sup>36</sup> Hulumtimi i opinionit publik “Raporti i qytetarëve ndaj diskriminimit në Serbi” gjendet në: [http://www.ravnopravnost.gov.rs/files/Izvestaj\\_diskriminacija\\_CPE\\_CeSID\\_UNDP\\_decembar\\_2012.pdf](http://www.ravnopravnost.gov.rs/files/Izvestaj_diskriminacija_CPE_CeSID_UNDP_decembar_2012.pdf).

diskriminimi është më i madh në punësim, kurse qytetarët e vërejnë diskriminim edhe gjatë dhënies së shërbimeve shëndetësore, në shkollim, përkatësisht në arsim.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se qytetarët janë të prirur të diskriminojnë grupet e caktuara (LGBT, pakicat fetare, të huajt) por këtë nuk e perceptojnë si diskriminim. Këto rezultate tregojnë për mungesën e vetëdijes së qytetarëve për diskriminim, përkatësisht për faktin se qëndrimet e tyre dhe sjellja janë diskriminuese. Kjo më së shumti shihet në raport me popullatën LGBT, për të cilën në opinion ende mbizotërojnë mendime të kundërta, si edhe në krahasim me pakicat kombëtare, për të cilat flitet shumë pak.

Hulumtimi tregon edhe për faktin se qytetarët në një masë të madhe janë homofobë, pak më shumë ka të atillë që janë jo tolerantë ndaj fesë se sa që janë tolerantë, si edhe se ksenofobia është e shprehur. Përveç kësaj, qytetarët e Serbisë tregojnë një shkallë të caktuar të stereotipeve negative ndaj romëve, dhe një fare sasive të antisemitizmit, por në të dy segmentet ka më shumë të atillë të cilët nuk kanë qëndrime negative. Janë më pak të prirur të diskriminojnë personat me invaliditet dhe të sëmurët nga HIV/AIDS por, njëkohësisht kanë distance të madhe sociale ndaj të sëmuërve nga HIV/AIDS-i, përkatësisht numri më i vogël i të anketuarëve është i gatshëm të hyjë në raporte të caktuara sociale me të sëmurin nga kjo sëmundje, gjë që gjithashtu mund të jetë shkak i diskriminimit.

Nga hulumtimi është e mundur të vërehen ndryshimet në distanca sociale të cilat ekzistojnë në mesin e grupeve shoqërore në Serbi nga viti 2009 deri më sot, përkatësisht shkallën e tolerancës, por edhe aftësitë që qytetarët t'u kundërvihen paragjykitimeve dhe të respektojnë të qenët i ndryshëm. Distanca sociale është më e madhe ndaj pjesëtarëve të popullatës LGBT, por e madhe është edhe ndaj personave HIV pozitivë, personave me invaliditet mendor, ndaj pakicave fetare, azilantëve dhe të huajve, kurse ndaj grupeve të tjera distance sociale është e vogël. Është evidente se gjatë disa viteve të fundit nuk është arritur të bëhen ndryshimet në distancë, gjë që konfirmon se distancat janë pjesë e paragjykitimeve dhe qëndrimeve të cilat formohen në periudhën e socializimit të rinjëve dhe që ato pas kësaj nuk ndryshojnë në vëllim më të madh dhe janë kategori e ndryshueshme vetëm gjatë një periudhe të gjatë kohore.

Hulumtimi ka treguar se institucionet të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk janë në masë të mjaftueshme transparente dhe që dy të tretat e qytetarëve nuk janë të sigurt ose nuk e dinë se cilave institucione mund t'u drejtohet nëse do t'i nënshtrohen diskriminimit. Ende është i dobët informimi i qytetarëve për institucionin e Komesarit për mbrojtjen e barazisë, për rolin e tij dhe kompetencat.

### 3.2 Diskriminimi në bazë të gjinisë dhe të identitetit gjinor

Diskriminimi në bazë të gjinisë është një nga format më të përhapura të diskriminimit në Serbi. Barazia e grave dhe e meshkujve është e garantuar me Kushtetutë dhe është përcaktuar obligimi i shtetit që të zhvillojë politikë të mundësive të barabarta<sup>37</sup>. Ligji për barazi të gjinive e përcakton që organet e pushtetit publik kanë për detyrë të zhvillojnë politikë aktive me mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës shoqërore, gjë që e nënkupton pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe të meshkujve në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit dhe të zbatimit të vendimeve të cilat janë me ndikim ndaj pozitës së femrave dhe të meshkujve<sup>38</sup>. Në Serbi edhe më tutje nuk ekziston statistikë e ndjeshme gjinore, përkatësisht grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për pozitën e e meshkujve dhe të femrave. Përfundim janë Shërbimi Kombëtar për Punësim dhe Enti Republikan për Statistikë<sup>39</sup>.

Të dhënat në disponim konfirmojnë se gratë janë në pozitë më të pavolitshme në krahasim me meshkujt në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Sidomos është brengosës diskriminimi i femrave në tregun e punës, në pikëpamje të pjesëmarrjes në vendimmarrje, diskriminimi i femrave në fushën ekonomike dhe në arsim, dhuna e bazuar në gjini ndaj femrave, jobarazimi gjinor në media etj.

Diskriminimi i grave në fushën e raporteve të punës dhe punësimit është mjaft i përhapur.<sup>40</sup> Ky vërehet në një shkallë më të vogël të aktiviteteve të grave në krahasim me meshkujt, në pozitën e tyre më të vështirë në tregun e punës, me shanse më të vogla për punësim dhe për përparim në punë, kompensim më të ulët për punë dhe etj.

Sipas të dhënave të Shërbimit Kombëtar për punësim<sup>41</sup>, në vitin 2012 nga gjithsej 761.834 persona të pa punë, 394.993 janë femra. Gjithashtu, të dhënat në disponim, tregojnë<sup>42</sup> se gratë i përbëjnë 80% të personave të cilët në mënyrë

<sup>37</sup> Neni 15 i Kushtetutës së RS

<sup>38</sup> Neni 3 i LBGJ

<sup>39</sup> Në vitin 2011 është botuar botimi i tretë me radhë "Gratë dhe meshkujt në Republikën e Serbisë", në të cilin janë paraqitur të dhënat statistikore të pasqyruara sipas gjinisë (i pari është botuar në vitin 2005, kurse i dyti në vitin 2008).

<sup>40</sup> Në vitin 2011 është botuar botimi i tretë me radhë "Gratë dhe meshkujt në Republikën e Serbisë", në të cilin janë paraqitur të dhënat statistikore të pasqyruara sipas gjinisë (i pari është botuar në vitin 2005, kurse i dyti në vitin 2008).

<sup>41</sup> Më shumë në botimin Diskriminimi i grave në tregun e punës. Shoqëria e Viktimologjisë në Serbi, 2012, [http://www.nsz.gov.rs/live/digitalAssets/o/380\\_bilten\\_nsz\\_-\\_decembar\\_2012.pdf](http://www.nsz.gov.rs/live/digitalAssets/o/380_bilten_nsz_-_decembar_2012.pdf).

<sup>42</sup> Gratë dhe meshkujt në Republikën e Serbisë, Republika e Serbisë, Enti Republikan për Statistikë, Beograd, 2011.

vullnetare e kanë braktisur punën për shkaqe familjare dhe 98% e atyre për të cilat e vetmja punë është amvisnia.

Gratë shtatzanë dhe lehonat janë veçanërisht në pozitë të vështirë, sepse edhe përkundër faktit se Serbia përpiqet për shtimin e natalitetit, si edhe që me ligje është garantuar mbrojtja e veçantë e këtyre kategorive të grave, të drejtat e tyre për punë shpesh shkelen. Veçanërisht brengos fakti se femrat të cilat punojnë me kohë të caktuar, nganjëherë edhe nga disa vjet , nuk ua vazhdojnë kontratën për punë kur mbeten shtatzanë.

### Nga praktika e Komesarit për mbrojtjen e barazisë

Janë pranuar **43 ankesa për shkak të diskriminimit në bazë të gjinisë dhe 3 në bazë të identitetit gjinor**. Më së shumti ankesa në bazë të këtyre bazave janë paraqitur për shkak të diskriminimit në fushën e punës dhe të punësimit (20), kurse 7 ankesa janë paraqitur për shkak të diskriminimit në procedurat para organeve të pushtetit publik, dhe 5 në fushën e informimit publik dhe media.

*- Paraqitësja e ankesës e ka theksuar se Fakulteti Juridik e ka refuzuar kërkesën e saj që për shkak të ndërrimit të emrit, pas ndërrimit të gjinisë nga gjinia mashkullore në femërore, i cili është krijuar pasiqë e ka fituar diplomën, të bëhet "korrigjimi" i diplomës dhe të lëshohet diploma e re në të cilën do të theksohet emri i saj i ri. Pas procedurës së zbatuar, Komesarja për mbrojtjen e barazisë e ka dhënë mendimin se me moslëshimin e diplomës, e cila do të kishte emër të ri, për shkak të ndërrimit të gjinisë, Fakulteti juridik ka bërë diskriminim indirekt në bazë të gjinisë. Me mendim është lëshuar edhe rekomandimi që Fakulteti juridik të ndër marrë të gjitha masat të cilat do të bëjnë të mundur që paraqitëses së ankesës dhe personave të tjerë të cilët pasiqë e kanë fituar diplomën e kanë ndërruar emrin për shkak të ndërrimit të gjinisë, me kërkesën e tyre të lëshohen diplomat e reja dhe dokumentet e tjera publike lëshimi i të cilave është në kompetenca të fakultetit, në të cilat do të theksohet emri i tyre i ri, duke i respektuar standardet e vendit dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së personave transgjinorë nga të gjitha mënyrat e diskriminimit. Fakulteti Juridik ka vepruar sipas rekomandimit dhe ia ka lëshuar diplomën paraqitëses së ankesës e cila e ka emrin e saj të ri.*

*Njëkohësisht, kjo ankesë ka qenë rast që, në bazë të autorizimit nga neni 33, paragrafi 9 i Ligjit për ndalimin e diskriminimit, u dërgohet rekomandimi të gjitha universiteteve në Serbi për aprovimin e masave që personat të fitojnë trajtimin e barabartë të cilët pasiqë e kanë marrë diplomën e kanë ndërruar emrin për shkak të ndërrimit të gjinisë, që fakultetet personave transgjinorë me kërkesën e tyre, t'ua lëshojnë diplomat e reja dhe dokumentet e tjera publike lëshimi i të cilave është në kompetenca të fakultetit, në të cilat do të theksohet emri i tyre i ri, dhe këtë në mënyrë të shpejtë, transparente dhe të arritshme, duke i respektuar standardet e vendit dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së personave transgjinorë nga të gjitha format e diskriminimit.*

Për shkak të diskriminimit në bazë gjinore, Komesari për mbrojtjen e barazisë i ka paraqitur **tri padi**:

- Padia e parë për shkak të kësaj forme të diskriminimit është paraqitur **kundër Lidhjes Futbollistike të Serbisë**, për shkak të diskriminimit të klubeve futbollistike të femrave në krahasim me klubet futbollistike për meshkuj, në bazë të gjinisë lojtarëve/lojtareve, me nenin 79, të Rregullores për regjistrim, status dhe transfer të lojtarëve të Lidhjes Futbollistike të Serbisë (Fletorja zyrtare “Futbolli” nga 20 qershori i vitit 2011), është përcaktuar kompensimi i shpenzimeve të investuara për trajnim dhe zhvillim të lojtareve të futbollit, të cilin e paguan Klubi i futbollit për femra për kalim të lojtareve së futbollit, është 15% nga kompensimi të cilin e paguan Klubi i futbollit për meshkuj për kalim të lojtarit të futbollit. Me aktgjykim të shkallës së parë është aprovuar në tërësi kërkesa e padisë së Komesarit për mbrojtjen e barazisë dhe është konstatuar se me përcaktimin e rregullave nga neni 79, i Rregullores, Lidhja Futbollistike e Serbisë e ka bërë diskriminimin e klubeve futbollistike të futbollit për femra, në bazë të gjinisë së lojtareve të tyre, është urdhëruar që të paditurit të mënjanojë dispozitën diskriminuese të përmbajtur në nenin 79, të Rregullores, kurse është urdhëruar edhe shpallja e aktgjykimit në një revistë ditore me tirazh kombëtar. Lidhja Futbollistike e Serbisë ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimit të theksuar, kurse Gjykata e Apelit në Beograd me aktgjykimin nga data 6 nëntor i vitit 2012 e ka refuzuar si ankesë të pabazë të LFS dhe e ka konfirmuar aktgjykimin e Gjykatës së Parë Komunale në Beograd. Mosmarrëveshja ka përfunduar me vendim të formës së prerë.
- Padia e dytë është paraqitur **kundër një banke** për shkak të kalimit të një gruaje në vend të punës më të ulët për shkak të kthimit të saj nga leja e shtatzanisë dhe mungesës nga puna për shkak të kujdesit për fëmijën e tretë. Procedura ende është në zhvillim e sipër, edhe pse padia është paraqitur më 17 shtator të vitit 2012. Pra, seance e pare gjyqësore është caktuar për 5 qershor të vitit 2013, kështu që Komesari për mbrojtjen e barazisë me memorie ka kërkuar nga gjykata të ndërmarë masa të domosdoshme që seance gjyqësore të caktohet brenda kohës sa më të shkurtër, duke e pasur parasysh parimin e urgjencës së proceseve gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi.
- Padia e tretë për shkak të diskriminimit në bazë të gjinisë është paraqitur **kundër zinxhirit të picerive** të cilat i punësojnë vetëm femrat në objektet e shitjes. Pas paraqitjes së shpalljes në pikat e shitjes “A dëshiro-ni të bëheni pjesë e ekipit “C”? Na nevojiten vajzat për punë në sportel“, anketuesit vullnetarë kundër diskriminimit janë paraqitur si kandidatë të interesuara për punë dhe kanë biseduar me të punësuarit dhe me personat të cilat janë paraqitur si kompetente për biseda për punë. Bisedat janë zhvilluar në tri pika shitëse në Beograd dhe në të tri vendet anketuesit të gjinisë mashkullore i kanë thonë se nuk mund të punësohet,

sepse politika e firmës është që të punësojë vetëm femra. Padia është paraqitur më 23 gusht të vitit 2012, kurse procedura para Gjykatës së Parë Komunale në Beograd është në zhvillim e sipër.

*Gjithashtu, Komesari për mbrojtjen e barazisë e ka paraqitur në vitin 2012 kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër shoqërisë ekonomike „T.M“ nga K, ish-punëdhënësit S.A. i cili, kundër obligimit ndaj programit për punësim “Shansi i parë” ka refuzuar që paraqitëses së padisë dhe kolegeve të saj t’ua vazhdojë kontratën për punë vetëm për shkak të shtatzanësisë. Procedura është në zhvillim e sipër.*

Gjatë vitit 2012, janë miratuar disa rekomandime masash për realizimin e barazisë për shkak të diskriminimit në bazë të gjinisë: Fondit Republikan për Sigurim Shëndetësor dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat janë rekomanduar që të ndër marrin masa me të cilat do të sigurojnë që gratë të cilat planifikojnë familje, shtatzënësi dhe lehonat deri 12 muaj pas lindjes të fitojnë të drejtën për sigurim shëndetësor sipas kësaj baze edhe në situata të cilat e kanë sigurimin sipas ndonjë baze tjetër, por në praktikë nuk realizohen për shkak se obliguesi i kontributeve për sigurim shëndetësor të obligueshëm, nuk po e kryen obligimin e pagimit të kontributeve; rekomandimi i masave për 19 qytete dhe komuna në Serbisë<sup>43</sup> është që në kuadër të kompetencave të veta dhe mjeteve buxhetore në disponom, të përkrahin në mënyrë financiare punën e organizatave të specializuara të shoqërisë civile nga rajoni i komunave të veta të cilat ua ofrojnë ndihmën edhe grave të cilat përjetojnë dhunë familjare/nga partneri; rekomandimi i masave për realizimin e barazisë në komunën e Prijepoles, me të cilën është rekomanduar që të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme që në vendimet për themelimin e bashkësive vendore, statuteve të tyre dhe akteve të tjera, në organet e bashkësive vendore dhe procedurat për zgjedhje në këto organe, të sigurohet barazia e gjinive dhe realizimi i mundësive të barabarta.

Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë i është dhënë rekomandimi që menjëherë të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në pajtim me autorizimet e veta, për t’u siguruar që në përbërje të të gjitha delegacioneve të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë në institucionet ndërkombëtare parlamentare, të jenë më së paku 30% e personave të gjinisë më pak të përfaqësuar, në pajtim me nenin 38, paragrafi 2 i Ligjit për barazinë e gjinive. Gjithashtu, Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë i është dhënë rekomandimi që të ndër marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që në përbërje të të gjitha këshillave parlamentare që njësoj të jenë të përfaqësuar personat e gjinisë më pak të përfaqësuar, në pajtim me garancinë kushtetuese të barazisë së meshkujve dhe fem

---

<sup>43</sup> Nish, Krushevc, Leskovc, Kragujevc, Kraljevë, Vlasotinca, Vranje, Kikindë, Novi Beçej, Smederevska Pallankë, Novi Sad, Vërshac, Pazar i Ri, Baçka Topollë, Savski Venac, Stari Gradi, Novi Beograd, Vračar dhe Palilulë.



rave dhe të obligimeve të organeve shtetërore që të zhvillojë politikën e mundësive të barabarta.

### 3.3 Diskriminimi në bazë të përkatësisë kombëtare dhe origjinës etnike

Pjesëtarët e pakicave kombëtare i janë nënshtruar diskriminimit, edhe pse pozita e tyre juridike veçanërisht është e rregulluar me Kushtetutën e RS dhe me ligje të veçanta – me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare,<sup>44</sup> dhe me Ligjin për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare<sup>45</sup>, si edhe me ligje të tjera në të cilat ekzistojnë dispozitat të cilat kanë të bëjnë me çështjet me interes për pakica kombëtare.

Rezultatet e hulumtimit<sup>46</sup> tregojnë se niveli më i lartë i distancës etnike ekziston ndaj shqiptarëve, pastaj vijnë kroatët, romët, boshnjakët dhe hungarezët. Nga ankesat të cilat i janë dërguar Komisarit për mbrojtje të barazisë mund të përfundohet se pjesëtarët e pakicave kombëtare shpesh ndjehen të diskriminuar, veçanërisht në procedurat para organeve të pushtetit publik, madje edhe në situata kur nuk ka shkelje të të drejtave për barazi.

Pozita e pakicës kombëtare rome në Serbi edhe më tutje është e vështirë, shpesh i nënshtrohen gjuhës së hapur, mjaft të pranishme dhe të përhapur të urrejtjes, kurse diskriminimi ndaj romëve më së shumti shprehet në fushën e arsimit, punësimit, mbrojtjes shëndetësore dhe banimit.

Në raportin e Këshillit të Evropës “Të drejtat e njeriut për romë dhe nomadë”<sup>47</sup> pohohet se shkaqet për pozitë të pavolitshme të romëve në Serbi është fakti se një numër i madh i pjesëtarëve të pakicës rome nuk kanë dokumente personale dhe që jeton në lagje informale. Hulumtimet kanë treguar se 72% e lagjeve të romëve është e palegalizuar (nga gjithsej 593), kurse në raportin e Këshillit të Evropës me brengosje është konsultuar se vetëm në Beograd ekzistojnë 137 lagje informale të romëve, dhe se gjatë vitit 2011 është regjistruar shtimi i numrit të nxjerrjeve me dhunë nga banesat<sup>48</sup>. Përveç kësaj, fëmijët e

<sup>44</sup> “Fletorja zyrtare e RFJ”, nr. 11/02, “Fletorja zyrtare e SMZ”, nr. 1/03 – Karta kushtetuese dhe “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 72/09 – ligji tjetër.

<sup>45</sup> “Fletorja zyrtare e RS”, nr. 72/09.

<sup>46</sup> Raporti i qytetarëve ndaj diskriminimit në Serbi, [http://www.ravnopravnost.gov.rs/files/Izvestaj\\_diskriminacija\\_CRE\\_CeSID\\_UNDP-decembar\\_2012.pdf](http://www.ravnopravnost.gov.rs/files/Izvestaj_diskriminacija_CRE_CeSID_UNDP-decembar_2012.pdf).

<sup>47</sup> Të drejtat e romëve dhe nomadëve në Evropë, Këshilli I Evropës, Strazburg, shkurt 2012. (Human rights of Roma and Travellers in Europe, Council of Europe).

<sup>48</sup> [http://www.coe.int/commissioner/source/prems/prems79611\\_GBR\\_CouvHuman-RightsRoma\\_WEB.pdf](http://www.coe.int/commissioner/source/prems/prems79611_GBR_CouvHuman-RightsRoma_WEB.pdf).



romëve gati fare nuk i vijojnë institucionet parashkollore, kurse sipas të dhënave të Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës, 62% e fëmijëve të romëve asnjëherë nuk e kanë ndjekur mësimin ose e kanë braktisur shkollën, kurse vetëm 9,6% e kanë vazhduar dhe e kanë kryer shkollimin<sup>49</sup>. Ekzistojnë indicionet se në sistemin arsimor diskriminimi ndaj romëve është i shprehur dhe që ky është një nga shkaqet kryesore pse fëmijët e romëve janë të përjashtuar nga Sistemi arsimor dhe pse shumica prej tyre herët e braktisin shkollimin dhe përfundojë me të arritura të ulëta arsimore<sup>50</sup>.

Ka edhe përmirësime të caktuara kur bëhet fjalë për pozitën e popullatës rome. Për shembull, është plotësuar Ligji për procedure jashtëgjyqësore<sup>51</sup>, kështu që është përcaktuar procedura e caktimit të kohës dhe të vendit të lindjes së personave të cilët nuk janë regjistruar në libra të amzës, me çfarë është bërë hapi i parë për zgjidhjen e problemit të të ashtuquajtur “personat juridikë të padukshëm”.

#### Nga praktika e Komesarit për mbrojtjen e barazisë

Gjatë vitit 2012 janë paraqitur 68 ankesa (17,2%) për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë kombëtare dhe originës etnike.

Më së shumti ankesa janë paraqitur në bazë të përkatësisë së pakicës kombëtare rome (31), kurse dukshëm më pak ankesa janë paraqitur në bazë të përkatësisë së pakicave të tjera kombëtare – shqiptare (4), maqedonase (4), boshnjake (3), kroate (3) dhe hungareze (3), por ka pasur edhe ankesa në bazë të përkatësisë së pakicës ukrainase, malazeze, sllovaqe, bullgare, çeke, rumune dhe pakicës vllehe. Është interesant se gjatë këtij viti janë pranuar 15 ankesa për diskriminim në bazë të përkatësisë kombëtare serbe.

Ngjashëm si edhe gjatë vitit të kaluar, nga ankesat të cilat janë paraqitur për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë kombëtare mund të përfundohet se pjesëtarët e pakicës kombëtare ndjehen të diskriminuara gati në të gjitha fushat e marrëdhënieve shoqërore, sidomos në veprimet para organet e pushtetit publik. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura sipas kësaj baze, 19 kanë të bëjnë me procedurë para organeve të pushtetit publik, kurse në shumicën e dosjeve nuk është konstatuar diskriminimi.

<sup>49</sup> Raporti i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës në Serbi, Këshilli i Evropës, Strazburg, 2011 (ECRI Second report on Serbia, Council of Europe).

<sup>50</sup> “Fl. Zyrtare e RSS”, nr. 25/82 dhe 48/88 dhe “Fl. Zyrtare e RS”, nr. 46/95 – ligji tjetër 18/2005 – ligji tjetër dhe 85/2012.

<sup>51</sup> Analiza e situatës së arsimit dhe inkuadrimin social të vajzave të romëve në Serbi. CARE Serbia, mars, 2011.

*- Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare hungareze nga Subotica e ka paraqitur padinë kundër Shërbimit Kombëtar për punësim. Në ankesë është theksuar se në procedurë të verifikimit të aftësive psikofizike të edukatorëve, arsimtarëve dhe të personelit tjetër mësimor, Shërbimi Kombëtar për punësim nuk ia siguron kushtet të cilat do të ishin të pranueshme për pjesëtarët e Pakicës Kombëtare Hungareze me rastin e testimit. Është miratuar mendimi se Shërbimi Kombëtar për punësim nuk i ka diskriminuar pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare me rastin e verifikimit të aftësive psikofizike për punë me fëmijë dhe me nxënës, duke e marrë parasysh se standardizimi i instrumenteve matëse psikologjike nuk është në kompetencë të tij, por për standardizim është e ngarkuar Shoqëria e psikologëve të Serbisë.*

Nga numri i përgjithshëm i ankesave për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë kombëtare, 10 kanë të bëjnë me fushën e marrëdhënieve të punës dhe punësim. Paraqitësit e ankesave pohojnë se janë trajtuar në mënyrë të ndryshme në krahasim me të punësuarit e tjerë për shkak të përkatësisë së vet kombëtare, por ka pasur edhe ankesa në të cilat paraqitësit kanë pohuar se janë diskriminuar tashmë në procedurë të punësimit, përkatësisht, se nuk janë pranuar në marrëdhënie pune sepse janë pjesëtarë të ndonjë pakice kombëtare. I kemi pranuar edhe nëntë ankesa për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë kombëtare në fushën e arsimit dhe të aftësimin profesional, kurse tetë në fushën e informimit publik dhe të mediave.

*Në paralajmërim nga 2 marsi i vitit 2012 në mënyrë më të ashpër të mundshme është dënuar sulmi ndaj gorarit Xhemil Limanit dhe është shprehur se pritet që kryerësit e këtij akti brutal do të dënohen në mënyrë adekuate. Opinioni është paralajmëruar se incidentet e motivuara me urrejtje ndaj secilit që është i ndryshëm po bëhen gati të zakonshme dhe që për shkak të kësaj organet shtetërore duhet të reagojnë në mënyrë më të vendosur dhe ta dënojnë dhunën. Gjithashtu, është theksuar se sulmet e këtilla dëshmojnë për domosdoshmërinë e angazhimit të të gjithëve, nga organet dhe institucionet kompetente deri te individët dhe individet, për përhapjen dhe afirmimin e vlerave të shoqërisë në të cilin të gjithë njerëzit janë të barabartë, pa kurrfarë dallimi në pikëpamje të kombësisë ose cilësdo veçorie tjetër personale.*

Më së shumti ankesa në bazë të përkatësisë kombëtare ka pasur për shkak të përkatësisë pakicës kombëtare rome, por mund të konstatojmë se numri i ankesave të dërguara sipas kësaj baze edhe më tutje është i vogël, nëse merret parasysh përhapja e diskriminimit ndaj kësaj pakice kombëtare.

- Organizata P. e ka paraqitur ankesën kundër Administratës së qytetit të B. Sekretariatit për mbrojtje sociale për shkak të kontratës për përdorimin e njësive mobile të banimit e lidhur midis Sekretariatit për mbrojtje sociale dhe shfrytëzuesit, pjesëtarëve të shpërngulur të pakicës rome, me të cilën, ndër të tjera, është përcaktuar se obligimi i shfrytëzuesit është sjellja e mirë ndaj përfaqësuesve të Sekretariatit për mbrojtje sociale, dërgimin e fëmijëve në shkollë dhe të kërkuarit aktiv të punës për përdorues me aftësi pune, pastaj njohtimi “rendi shtëpiak”, i cili dallohet nga aktet e ngjashme në njësi banimi në të cilat nuk jetojnë romët sipas asaj që në mënyrë taksative janë theksuar sjelljet e ndaluara dhe paralajmërimi me shkrim, me të cilin u është ndaluar përdoruesve që në njësitë e tyre të banimit të bujnë mysafirët. Është konstatuar se me këto akte po diskriminohen romët, përdoruesit e njësive mobile të banimit në bazë të përkatësisë së tyre kombëtare dhe është rekomanduar ndryshimi i akteve kontestuese të kontratës për përdorimin e njësive mobile të banimit, si edhe ndryshimi i “rendit shtëpiak” dhe mënjanimi i paralajmërimit me shkrim.

- Organizata R. c. m. nga B., e ka paraqitur ankesën kundër O. A, për shkak të “shakasë” ofenduese të cilën e ka shkruar në Profilin e Tuterit të vet, e cila e ka këtë përmbajtje: „Përcjellja afariste e romëve – këlyshët që shkojnë pas tyre derisa mbledhin kartonë.” Pas procedurës së zbatuar është miratuar mendimi se me këto tekste është ofenduar dinjiteti i pjesëtarëve dhe i pjeëtareve të pakicës kombëtare rome, me çfarë është bërë akt i diskriminimit / shqetësimi dhe sjellja nënçmuese, por edhe është lëshuar rekomandimi përkatës. Sipas këtij rekomandimi është vepruar edhe këtë ashtu që në ambiente të Komesarit për mbrojtjen e barazisë është organizuar mbledhja e përfaqësuesve të R. c. m. nga B, organizatë e cila lufton për mbrojtjen e të drejtave të pakicës kombëtare rome dhe O. A. që drejtpërsëdrejti të mësojë se me cilat probleme është duke u ballafaquar bashkësia rome në jetën e përditshme, si edhe si ka ndikuar ndaj tyre teksti me këtë përmbajtje.

Për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë kombëtare rome është miratuar edhe rekomadimi i masave për realizimin e barazisë i cili i është dërguar qytetit të Nishit. Është rekomanduar ndërmarrja e masave që pjesëtarëve të përkatësisë kombëtare rome të cilët janë shpëngulur nga lagjja pranë “Belvilit” në Beogradin e Ri dhe janë vendosur në deponë në rrugën Daniçiq në Nish, është siguruar banimi i cili i plotëson standardet ndërkombëtare të akomodimit në banimin alternativ të qytetarëve të cilët shpërngulen na lagjet informale. Gjithashtu është rekomanduar edhe se procesi i brengosjes dhe integritimit të pjesëtarëve të shpërngulur të pakicës kombëtare rome në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen aktive të personave të shpërngulur, duke i respektuar nevojat e tyre dhe të drejtën e pjesëmarrjes për miratimin e vendimeve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta, duke përfshirë shpërnguljen dhe mënyrën e integritimit shoqëror, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe orientimet për shpërnguljen e qytetarëve nga lagjet informale. Fatkeqësisht, edhe përkundër shprehjes së gatishmërisë që të veprohet sipas rekomandimit, pushteti i qytetit nuk e ka zbatuar rekomandimin e Komesares.

Gjithashtu, Komesarja për mbrojtjen e barazisë për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë pakicës kombëtare rome i ka paraqitur **dy padi**.

- Padia e parë kundër Vasa Keniçit nga Svërliku, i cili më 3 qershor të vitit 2011 gazetares së Radio Televizionit të Serbisë i ka dhënë deklaratë lidhur me informatën se J.M. me pesë fëmijë do të vendoset në ndërtesën në të cilën ai jeton: „Nuk është shumë në interesin tonë që një rome të banojë në ndërtesën tonë. Ka shumë fëmijë, pesë fëmijë ... ajo... ku ta dijë unë. Kjo është mungesë rregulli. Romët janë romë... Ju e dini si, ata gjithnjë kanë ndonjë lagje të veçantë, të ndarë dhe ato gjërat tjera.” Ky vëzhgim është emituar më 6 qershor të vitit 2011 në RTS. Në bazë të kësaj padie është marrë aktgjykimi i formës së prerë me të cilin është përcaktuar forma e rëndë e diskriminimit të drejtpërdrejtë të pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakics skombëtare rome – të shkaktuarit dhe nxitja e jobarazisë, urrejtjes dhe intolerancës në bazë të përkatësisë kombëtare. Të paditurit i është ndaluar që në të ardhmen të japë deklarata dhe të paraqesë qëndrime me të cilat diskriminohet pakica kombëtare rome, është urdhëruar që me shpenzime të veta botojë të kërkuarit falje në gazeta ditore me tirazh kombëtar, si edhe shpallja e aktgjykimit në gazeta ditore me tirazh kombëtar, me shpenzime të të paditurit.
- Padia e dytë është paraqitur kundër restorantit të ushqimit të shpejtë „M.D.“ sepse një punëtor i sigurimit nuk ua ka lejuar fëmijëve të kombësisë rome të hyjnë në restorant me një grua cila ka dashur t’u blejë ushqim në restorant. Gjykata e shkallës së parë me aktvendim të datës 30 tetor të vitit 2012 e ka refuzuar padinë, duke e marrë parasysh se prokurori nuk e ka pasur pëlqimin e personave për të cilët pohohet se është ndërmarrë veprimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë. Komesari për mbrojtjen e barazisë më 19 dhjetor të vitit 2012 e ka paraqitur ankesën ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe procedura është duke u zhvilluar pranë Gjykatës së Lartë në Beograd për vendim-marrje sipas ankesës. Lidhur me këtë rast është paraqitur edhe **denoncimi penal**.

Komesari për mbrojtjen e barazisë i ka paraqitur kërkesat për fillimin e **dy procedurave kundërvajtëse** për shkak të diskriminimit në fushën e edukimit dhe të arsimit në bazë të përkatësisë së pakicës kombëtare rome. Një denoncim kundërvajtës është paraqitur kundër institucionit parashkollor dhe drejtorit të institucionit parashkollor në lagjen Dezheva-Vozhegërnci te Pazari i Ri për shkak të segregacionit të fëmijëve romë nga lagjet e shpërngulura, të cilët e vijnë programin përgatitës parashkollor **në grup të veçantë dhe në ndërtesë të veçantë**, në krahasim me fëmijët e kombësisë serbe dhe boshnjake. Denoncimi tjetër kundërvajtës është paraqitur kundër shkollës fillore dhe drejtorit të shkollës fillore në të njëjtin vend për shkak të segregacionit të fëmijëve romë nga familjet e shpërngulura, të cilët e vijnë klasën e parë dhe të katërt të shkollës fillore **në klasa të veçanta dhe në ndërtesë të veçantë**, në krahasim me fëmijët e kombësisë serbe dhe boshnjake. Kjo procedurë ende gjithnjë është duke u zhvilluar.

### 3.4 Diskriminimi në bazë të invaliditetit

Gjatë viteve të fundit është përmirësuar korniza normative dhe është shtuar transparencja e personave me invaliditet, por personat me invaliditet edhe më tutje janë në pozitë më të vështirë në krahasim me qytetarët e tjerë. Diskriminimi i personave me invaliditet, ekziston në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe private, kurse më i shprehuri është në fushën e punësimit, arsimit, hyrjes në objekte, marrjes së shërbimeve dhe banimit. Pozita e personave me invaliditet mund të shqyrtohet përmes shkallës së lartë të papunësisë, shkallës së ulët të arsimit, varfërisë, mospërfaqësimit politik, dhunës të cilës veçanërisht i janë nënshtruar gratë me invaliditet, rrezikut nga institucionalizimi, si edhe trajtimi i vështirësuar për të hyrë në objekte publike, sipërfaqe dhe shërbimeve.

Përparim pozitiv për çështjen e arsimit të fëmijëve me pengesa në zhvillim dhe invaliditet është vendosja e arsimit inkluziv<sup>52</sup>, gjë që e ka mundësuar që një numër më i madh i fëmijëve të regjistrohen në shkollat të rregullta, por ende gjithnjë janë të shpeshta rastet e diskriminimit të fëmijëve me pengesa në zhvillim në realizimin e të drejtave në arsim që i respekton nevojat e tyre arsimore dhe edukative. Gjithashtu, ka përparim edhe në fushën e punësimit, por ende vëmendje të madhe duhet t'i kushtohet punësimit të personave me invaliditet, sepse papunësia e përgjithshme e personave me invaliditet është tri herë më e madhe se sa te popullsia tjetër.

Pamundësia për të hyrë në objekte dhe sipërfaqe edhe më tutje është një nga problemet themelore për realizimin e barazisë së personave me invaliditet, edhe pse është përcaktuar që objektet dhe sipërfaqet në përdorim publik duhet të ndërtohen në pajtim me standardet që të mund të përdoren<sup>53</sup>. Mirëpo, shumë objekte nuk mund të përdoren, duke përfshirë edhe ambientet e zyrave të organeve shtetërore, gjë që e vështirëson realizimin e drejtave të shumta dhe e bën të pamundur inkluzionin shoqëror të personave me invaliditet.

#### **Nga praktika e Komesarit për mbrojtjen e barazisë**

Në vitin 2012 më së shumti ankesa ka pasur ndaj diskriminimit në bazë të invaliditetit - 76 (19,2%). Nga ankesat mund të përfundohet se diskriminimi i personave me invaliditet është i pranishëm edhe më tutje në gati të gjitha fushat e jetës shoqërore. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 20 ankesa janë paraqitur kundër diskriminimit në bazë të invaliditetit me rastin e dhënies së shërbimeve publike ose me rastin e përdorimit të objekteve, 15 ankesa kanë të bëjnë me procedure para organeve të pushtetit publik, ndërsa 14 ankesa kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të invaliditetit në fushën e punës dhe të punësimit. Num-

<sup>52</sup> Ligji për bazat e sistemit të edukimit dhe të arsimit, "Fletorja zyrtare e RS", nr. 72/09 dhe 52/11

ri pak më i vogël i ankesave është pranuar në fushat e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, si edhe të sigurimit pensional dhe invalidor.

- Paraqitësi i ankesës është personi me invaliditet i cili i përdor karrocet e invalidëve, e ka kuadriplegjinë për shkak të së cilës nuk mund të shkruajë, por vetëm nënshkruhet me faksimil. E ka theksuar se në Administratën e bashkisë së qytetit të B. nuk është e lejueshme të vulosë faksimilin, por është dërguar në gjykatë, por që në gjykatë, vetëm pas ndërhyrjes së shefit të zyrës për vulosjen e nënshkrimeve, e ka marrë lejen të vulosë faksimilin. Në bazë të kësaj ankese janë zbatuar dy procedura të veçuara: kundër Bashkisë së qytetit të B., për të cilën është përcaktuar se është bërë diskriminim - shkeljen e parimeve të të drejtave dhe obligimeve të barabarta të personit me invaliditet, dhe kundër gjykatës për të cilën nuk është përcaktuar se i ka diskriminuar personat me invaliditet. Pas procedurave të zbatuara, këtyre organeve shtetërore u është rekomanduar që të gjithë personave me invaliditet të cilët nuk mund të shkruajnë dhe për këtë arsye e përdorin faksimilin, t'ua mundësojnë përdorimin e papenguar të faksimilit në vend të nënshkrimit të vet.

- Paraqitësi i ankesës e ka theksuar se është diskriminuar në bazë të invaliditetit me rastin e paraqitjes në evidencë të Shërbimit Kombëtar për Punësim, sepse së pari nuk i është mundësuar që gjatë paraqitjes dhe bisedës të marrë pjesë interpreti për gjuhë me shenja, kurse pas kësaj i është nënshtruar sjelljes ofenduese. Në procedurë është konstatuar se personat zyrtarë të punësuar në filial të Shërbimit Kombëtar për punësim në B. kanë vepruar në mënyrë ofenduese ndaj paraqitësit të ankesës, me rastin e paraqitjes së tij në evidence të Shërbimit kombëtar për punësim, si edhe që një sjellje e tillë është shkaktuar nga fakit se bëhet fjalë për person me invaliditet të cilit i nevojitet interpreti për gjuhë me shenja. Bashkë me mendim është dhënë edhe rekomandimi që Shërbimi Kombëtar për punësim t'i kërkojë falje me shkrim M. G. për shkak të shqetësimit dhe veprimit nënçmues të personave zyrtarë, por gjithashtu edhe të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme që t'u sigurohet të gjithë personave me invaliditet, që me rastin e përdorimit të shërbimeve të Shërbimit Kombëtar për punësim, t'u mundësohet procedura e cila i respekton veçantitë individuale dhe e parandalon secilën formë të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Komesari për mbrojtjen e barazisë gjatë vitit të kaluar e ka paraqitur **një padi kundër diskriminimit në bazë të invaliditetit**. Padia është paraqitur më 2 tetor të vitit 2011 kundër sipërmarrësit M.A, pronarit të dyqanit „P. C.“ duke e marrë parasysh se ky objekt hotelierie ka refuzuar ta shërbejë një grup të personave të rinj me invaliditet. Gjykata e Parë Komunale në Beograd më 22 janar të viti 2013 e ka marrë aktgjykimin për shkak të lëshimit me të cilin në tërësi është aprovuar kërkesa paditëse e Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

Për shkak të diskriminimit në bazë të invaliditetit është dhënë edhe **rekomandimi i masave për realizimin e barazisë** në Ndërmarrjen publike „Drejto-



ria për ndërtim të qytetit të Nishit”, me të cilën është rekomanduar që të gjitha sipërfaqet e reja të ndërtuara dhe të rikonstruktura publike në qytet të mund t’i përdorin personat me invaliditet, në pajtim me standardet e përcaktuara për përdorim. Ky rekomandim ende nuk është zbatuar plotësisht.

Duke e marrë parasysh pozitën e veçantë dhe të pavolitshme të personave me invaliditet në shoqërinë tonë, të cilët përjetojnë diskriminim të tërthortë në gati të gjitha fushat e jetës, por edhe për shkak të numrit më të madh të ankesave për diskriminim në bazë të invaliditetit, Komesari për mbrojtjen e barazisë po e përgatit Raportin e parë të veçantë i cili i është kushtuar pozitës së personave me invaliditet.

### 3.5 Diskriminimi në bazë të orientimit seksual

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual ende gjithnjë është mjaft i përhapur në Serbi, si në hapësirën publike ashtu edhe private. Ngjarja e cila e ka shënuar edhe këtë vit gjithsesi është Parada e krenarisë e cila nuk u mbajt në tetor të vitit 2012. Edhe gjatë këtij viti para Paradës së krenarisë është shtuar transparenca e problemeve me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e bashkësisë LGBT në Serbi, por njëkohësisht është shtuar edhe transparenca e qëndrimit negativ shoqëror ndaj personave LGBT, homofobisë, intolerancës, diskriminimit dhe dhunës të cilës i janë nënshtruar për çdo ditë. Veçantia e pozitës së popullatës LGBT shihet edhe në faktin se ata janë grupi i vetëm e drejta e të cilëve kontestohet për tubim publik dhe gjatë të cilit gjatë viteve të fundit është duke u zhvilluar shqyrtimi në opinion, edhe përkundër ekzistimit të garancisë kushtetuese të lirisë së tubimit. Në kuadër të Javës së krenarisë, është mbajtur tërë një sërë manifestimesh për t’u theksuar problemet e popullatës LGBT.

**Në paralajmërim nga** 14 shtatori i vitit 2012, është shprehur brengosja e madhe për shkak të faktit se tri javë pak para paralajmërimit të Paradës së krenarisë dhe manifestimeve të cilat janë paralajmëruar lidhur me këtë rast, gjithnjë e më të numërta janë kërcënime, gjuha e urrejtjes dhe dhuna ndaj popullatës LGBT. Është theksuar se me kërcënime të hapura dhe me dhunë po krijohet atmosfera e frikës dhe po nxitet intoleranca, urrejtja dhe armiqësia ndaj personave LGBT, gjë që është edhe njëllaj përhapjeje që të krijohet një alibi për mosmbajtjen e Paradës së sivjeme të krenarisë. U është shprehur përkrahja e parazervë të gjithë personave LGBT dhe është theksuar se shteti dhe organet e tij të pushtetit duhet të tregojnë fuqi dhe gatishmëri që të mbrojnë të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, duke përfshirë edhe të drejtën për tubim të qetë dhe liri të të folurit.

Gjatë këtij viti janë paraqitur 8 ankesa për shkak të diskriminimit në bazë të orientimit seksual, kurse vetëm në një rast është konstatuar diskriminimi. Dy procedura ende gjithnjë janë duke u zhvilluar, kurse 6 kanë përfunduar në vitin 2012. Një numër i vogël i ankesave për shkak të diskriminimit në bazë të orientimit seksual dëshmon për faktin se kjo formë e diskriminimit ende gjithnjë nuk

paraqitet në masë të mjaftueshme.

- Organizata L. e ka paraqitur ankesën kundër dr. M. B. profesorit të F. z. k. m. „M. u.“ në B., në të cilën pohohet se prof. dr. M. B. në ligjëratë me student ka deklaruar se “homoseksualiteti është sëmundje dhe që do të duhej kështu të regjistrohet siç është tëmthi në lukth, dhe se homoseksualiteti shërohet me ndryshimin e gjinisë.” Pas procedurës së zbatuar Komisarja për mbrojtjen e barazisë e ka dhënë mendimin se prof. dr. M. B. ka folur për homoseksualitetin duke e përmendur në këtë kontest “sëmundjen” “shërimin” dhe “ndërrimin e gjinisë” dhe duke e vënë në pyetje vlefshmërinë e vendimit me të cilin ai është mënjeluar nga lista e sëmundjeve, me çfarë ka kontribuar për krijimin e ambientit rrethues nënçmues dhe të ofendueshëm ndaj personave LGBT. Bashkë me mendim është lëshuar edhe rekomandimi se prof. dr. M. B. në të ardhmen duhet të kenë kujdes që atë që ua thonë studentëve për homoseksualitetin të jetë krejtësisht e qartë dhe e padyshimtë, duke pasur parasysh me këtë rast që disa deklarata të pasakta mund të kontribuojnë për krijimin dhe mbajtjen e stereotipeve, paragjytimeve dhe intolerancës ndaj personave LGBT, mund ta ofendojnë dinjitetin e tyre edhe në krahasim me ta të krijojnë ambient nënçmues dhe të ofendueshëm.

### 3.6 Diskriminimi në bazë të statusit martesor dhe familjar

Gjatë vitit 2012 janë pranuar gjithsej 22 ankesa për shkak të diskriminimit në bazë të statusit martesor dhe familjar.

- Paraqitësja e ankesës është nisur për të blerë bashkë me bashkëshortin dhe foshnjen, kur në hyrje të objektit të shitjes „M“ d.o.o. në K., i ka ndalur një punëtor i cili i ka njohtuar se nuk mund të hyjnë me karrocë për foshnje. E ka theksuar se e ka pyetur punëtorin në hyrje a kanë ata karroca të veta për foshnje dhe që e ka marrë përgjigjen se nuk kanë. Pas kësaj ajo dhe bashkëshorti i saj e kanë braktisur këtë objekt të shitjes, sepse janë penguar që të bëjnë blerjen, dhe që me këtë rast fëmija i tyre të jetë i sigurt. Është konstatuar se me Kushtet e përgjithshme të shitjes për blerje dhe për hyrjen e blerësve „M“ sh.p.k., nga B., e ka parashikuar ndalimin e hyrjes në objekte shitëse me karroca për fëmijë, dhe që me këtë rast nuk e ka bërë të mundur ndonjë mënyrë tjetër që blerësit të cilët shkojnë me fëmijë të hyjnë në objekt për shitje, me çfarë kjo kategori e blerësve është e diskriminuar në pikëpamje të mundësisë së përdorimit të shërbimeve në bazë të statusit familjar, kështu që në pajtim me këtë është dhënë rekomandimi që të sigurojnë hyrjen e papenguar dhe të sigurtë në objekte të shitjes për personat të cilët shkojnë me fëmijë.

Për shkak të diskriminimit në bazë të statusit martesor dhe familjar, Komisarja për mbrojtjen e barazisë e ka paraqitur **padinë kundër qytetit të Jagodinës**, për shkak të Vendimit për ndihmë financiare bashkëshortëve nr. 011-92/10-10-1, të cilin Kuvendi i qytetit të Jagodinës e ka miratuar më 23 dhjetor të vitit 2010.



Vendimi i përmban kushtet me të cilat e drejta për ndihmë financiare në mënyrë të paarsyeshme u është suprimuar disa kategorive të qytetarëve dhe të qytetareve, dhe këtë: atyre të cilët kanë lidhur bashkësi jashtëmartesore, atyre të cilët nuk kanë lindur në Jagodinë, atyre të cilët para lidhjes së martesës kanë fëmijë nga bashkësi jashtëmartesore, si edhe atyre të cilët para lidhjes së martesës kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin nga 17 janari i vitit 2012 e ka refuzuar si të pabazë kërkesë padinë e Komesarit për mbrojtjen e barazisë me të cilin ka kërkuar që të urdhërohet i padituri që nga Vendimi për ndihmë financiare çiftëve bashkëshortor të heqë kushtet me të cilat të drejtën për të fituar ndihmën financiare në mënyrë të paarsyetueshme u është suprimuar disa kategorive të qytetarëve dhe të qytetareve dhe këtë: atyre të cilët kanë lidhur martesë jashtëmartesore, atyre të cilët nuk kanë lindur në Jagodinë, atyre të cilët para lidhjes së martesës kanë fëmijë nga bashkësi jashtëmartesore, si edhe tyre të cilët para lidhjes së martesës kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore. Sipas ankesës së Komesares për mbrojtjen e barazisë Gjykata e Apelit në Kragujevc me aktvendimin e 6 nëntorit të vitit 2012 e ka suprimuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Jagodinë dhe e ka kthyer për rivendimmarrje. Meqenëse Kuvendi i qytetit të Jagodinës, në seancën nga 18 qershori i vitit 2012 e ka marrë Vendimin për ndërprerjen e vlefshmërisë së vendimit për ndihmë financiare çiftëve bashkëshortor, Komesari për mbrojtjen e barazisë e ka tërhequr padinë për këtë çështje juridike dhe procedura ka përfunduar.

Lidhur me këtë vendim, Komesari për mbrojtjen e barazisë e ka paraqitur edhe **propozimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë**, por meqenëse Kuvendi i qytetit të Jagodinës e ka marrë Vendimin për pushimin e vlefshmërisë së Vendimit për ndihmë financiare çiftëve bashkëshortorë, Komesari për mbrojtje të barazisë e ka tërhequr propozimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë në korrik të vitit 2012.

### 3.7 Diskriminimi në bazë të gjendjes pronësore

Në bazë të gjendjes pronësore janë pranuar 22 ankesa, nga të cilat nga 4 ankesa kanë të bëjnë me procedurat para organeve të pushtetit publik, procedurën e punësimit dhe të arsimit dhe aftësimi profesional. Gjendja pronësore është theksuar si bazë në të gjitha ankesat, kryesisht duke e theksuar edhe ndonjë bazë diskriminimi. Paraqitësit e ankesave pohojnë se disa të drejta u janë shkurtuar pikërisht për shkak të gjendjes së rëndë pronësore, por gjatë procedurave sipas ankesave nuk ka pasur dëshmi me të cilat do të mbëshetej një pohim i këtillë.

### 3.8 Diskriminimi në bazë të moshës

Janë pranuar 31 ankesa për shkak të diskriminimit në bazë të moshës. Numri më i madh ka pasur të bëjë me fushën e punës dhe të punësimit, kurse numri shumë më i vogël me fushën e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale.

*- Paraqitësi i ankesës ka theksuar se në Rregullore për llojin e barnave të cilat përcaktohen dhe lëshohen në ngarkesë të mjeteve të sigurimit të obliguar shëndetësor janë numëruar barnat e caktuara për të cilat janë përcaktuar ku-fizimet në përcaktim në krahasim me vitet e jetës së personit të siguruar. Pra, personat e sëmurë nga karcinomi metastatik i prostatës, e të cilët janë më të moshuar se 75 vjet, si edhe gratë e sëmura nga karcinomi i gjinjve, për nevoja të kastrimit medikamentoz, e të cilat janë më të moshuara se 40 vjet, nuk mund t'i marrin barnat e theksuara në ngarkesë të sigurimit të obliguar shëndetësor, por duhet t'i sigurojnë me mjete të veta. Procedura sipas kësaj ankese ende gjithnjë është duke u zhvilluar.*

Është miratuar një rekomandim i masave për realizimin e barazisë me të cilin Spitalit të përgjithshëm në Shabac i është rekomanduar që të ndryshojë Rregulloren për procedurën e themelimit të marrëdhënies së punës, dhe këtë në pjesën në të cilën janë parashikuar kriteret dhe vlerësimi që kanë të bëjë me moshën e kandidatit dhe të kandidatës.

### **3.9 Diskriminimi në bazë të anëtarësimit në organizata politike, sindikale dhe në organizata të tjera**

Gjatë vitit 2012 janë pranuar 26 ankesa për shkak të diskriminimit në bazë të anëtarësimit në organizata politike, sindikale dhe në organizata të tjera, nga të cilat 18 kanë të bëjnë me marrëdhënie të punës dhe me punësim.

*- Paraqitësi i ankesës ka theksuar se ka qenë në këshill sindikal, por që punëdhënësi i ka lëshuar shtatë anëtarë të këshillit sindikal, kështu që i ka aktivizuar marrëveshjet blanko të ndërprerjes së kontratës për punë. Gjykata e ka përcaktuar se pushimi nga puna ka qenë joligjor, dhe që është shkaktuar me faktin se paraqitësi i ankesës ka qenë përfaqësues sindikal. Pas përfundimit të procedurës gjyqësore dhe kthimit në punë, paraqitësit të ankesës punëdhënësi nuk ia ka mundësuar të punojë, por në mënyrë të vazhdueshme ia ka dhënë vërtetimet që të kthehet në shtëpi. Në procedurën para Komesarit për mbrojtjen e barazisë është konstatuar se paraqitësit të ankesës i është suprimuar mundësia të punojë në vend të vet të punës në një periudhë më të gjatë kohore dhe që i kryen obligimet e punës për të cilat merr pagë, dhe kështu në këtë mënyrë është vënë në pozitë të pabarabartë në krahasim me të gjithë të punësuarit e tjerë të cilët kanë mundësi që në bazë të punës së realizuar të marrin kompensimin në të holla. Punëdhënësi është rekomanduar që t'ia mundësojë paraqitësit të ankesës që ta kryejë punën në vendin e vet të punës nën kushte të barabarta si edhe të punësuarit e tjerë.*

- Paraqitësja e ankesës e ka theksuar se qyteti Sh., po e diskriminon sepse nuk ka mundësi që të realizojë të drejtën për subvencionim të llogarisë për shërbime komunale për personat me invaliditet që është përcaktuar me vendim të qytetit, dhe këtë për shkak se nuk është anëtar i ndonjë shoqate të caktuar të personave me invaliditet. Pra, sipas përfundimeve të qytetit vetëm anëtarët e shoqatave të caktuara persona me invaliditet mund ta realizojnë këtë të drejtë. Është përcaktuar diskriminimi i personave me invaliditet në bazë të anëtarësisë në ndonjë shoqatë, kurse qytetit i është propozuar që të ndër marrë masa përkatëse për të mundësuar që të gjithë personat me invaliditet nën kushte të barabarta të realizojnë të drejtën për subvencionim të llogarive të shërbimeve komunale, pa e marrë parasysh faktin a janë anëtarë të ndonjë shoqate të personave me invaliditet.

### 3.10 Diskriminimi në bazë të bindjeve fetare dhe politike

Për shkak të diskriminimit në bazë të bindjes fetare ose politike në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, janë paraqitur 32 ankesa. Është interesant se 13 ankesa i ka paraqitur një organizatë e shoqërisë civile dhe të gjitha kanë pasur të bëjnë me diskriminimin e ateistëve. Lidhur me dy ankesa është aprovuar mendimi se nuk është bërë akt i diskriminimit, kurse në ankesa të tjera të cilat i ka paraqitur kjo organizatë ka qenë e qartë se nuk ka shkelje të të drejtave në vështrim të Ligjit për ndalimin e diskriminimit, sepse paraqitësit e kanë bërë me dije shkeljen e parimeve të sekularitetit.

- Ankesa kundër Qendrës shëndetësore K. për shkak të ndërtimit të kishës ortodokse në truall të spitalit. Paraqitësit e ankesës konsiderojnë se me këtë është bërë diskriminimi i të gjithë qytetarëve të K., të cilët nuk janë krishterë ortodoksë e të cilët janë të punësuar në Qendrën shëndetësore ose shërohen në të. Në ankesë është theksuar se në këtë mënyrë Qendra shëndetësore “përkufizohet si ortodokse dhe e vendos këtë religjion si të obliguar dhe me këtë drejtpërsëdrejti i ofendon të gjithë të punësuarit dhe pacientët” dhe i privilegjon qytetarët ortodoksë.

- Ankesa kundër Kuvendit të qytetit të K., për shkak të vendosjes së kryqit ortodoksë në hyrje të K. Paraqitësit e ankesës konsiderojnë se me këtë është bërë diskriminimi i të gjithë qytetarëve të K., të cilët nuk janë besimtarë ortodoksë, si edhe që me këtë qyteti i K., po përkufizohet si qytet ortodoksë dhe po e vendos këtë religjion si shtetëror ose të obliguar.

- Ankesa kundër këshilltarit të Kuvendit të qytetit të N.S., për shkak të vizitës zyrtare një prelati kishtar. Paraqitësit e ankesës konsiderojnë se anëtarët e këshillave me këtë kanë bërë diskriminim ndaj të gjithë njerëzve të cilët nuk janë fetarë ortodoksë.

### 3.11 Diskriminimi në bazë të veçorive të tjera personale

Në vitin 2012 nuk ka pasur ankesa në bazë të veçorive gjenetike, kurse për shkak të diskriminimit në bazë të dënimeve penale, paraardhësve, lindjes, racës, gjuhës, pamjes, ngjyrës së lëkurës dhe shtetësisë janë paraqitur gjithsej 17 ankesa.

*- Komisioni për zgjedhjen e pjesëmarrëve të aftësisimit profesional në Qendrën për trajnim themelor policor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, e ka refuzuar denoncimin e M.S., nga Z. në konkursin për regjistrim të pjesëmarrësve të klasës së VII dhe VIII në Qendër për trajnim themelor policor sepse, siç është theksuar, nuk e ka dëshmuar se nuk ka shtetësi të dyfishtë. Denoncimi i M.S. është refuzuar për shkak të kinse mosplotësisimit të kushteve në pikëpamje të shtetësisë, por vendimi nuk është bazuar në ndonjë fakt ose dëshmi të përaktuar, por është marrë në bazë të supozimeve që M.S. e ka dyshtetësinë, sepse vetëm që nga vitit 1998 është regjistruar në librin e amzës për shtetasit jugosllavë. Me një veprim të këtillë Komisioni ka bërë akt të diskriminimit në bazë të veçorisë së supozuar personale të M. S. – shtetësisë së dyfishtë.*

Në 31 ankesa si bazë është theksuar ndonjë veçori personale e cila nuk është theksuar shprehimisht në Ligjin për ndalimin e diskriminimit (pensionisti, nëpunësi shtetëror, personi refugjat, kërkuesit e azilit dhe të ngjashme).


*- Në procedurën pranë ankesës së J.M. është konstatuar se me përfundimet e kryebashkiakut të qytetit të B. në bazë të të cilave ndihma në të holla paguhet për çdo tre muaj prej nga 4000,00 dinarë pensionistëve të cilët e kanë vendbanimin në territorin e qytetit të B., dhe të ardhurat në bazë të pensionit më të vogël se 13.000,00 dinarë në muaj, u është pranuar e drejta në të holla vetëm atyre pensionistëve të cilët stazhin e punës e kanë realizuar në tërësi në Republikën e Serbisë, me të cilën gjë janë diskriminuar pensionistët të cilët një pjesë të stazhit të punës e kanë fituar në përpjesëtim në shtetet e tjera, dhe gjenden në të njëjtën situatë, domethënë e kanë vendbanimin në territorin e qytetit të B., dhe të ardhurat e përgjithshme sipas bazës së pensionit i kanë më të vogla se 13.000,00 dinarë në muaj.*

### 3.12 Fusha e marrëdhënieve shoqërore me të cilën kanë të bëjnë ankesat

Ankesat të cilat kanë arritur gjatë vitit 2012 kanë të bëjnë me fushën e marrëdhënieve të punës dhe punësisimit (35,1%), procedurat para organeve të pushtetit publik (18,1%), fusha të cilat nuk janë theksuar shprehimisht në Ligjin për ndalimin e diskriminimit (9,2%), arsimi dhe aftësimi profesional (8,2%), dhënia e shërbimeve publike dhe përdorimi i objekteve dhe i sipërfaqeve (7,1%), mar-

rëdhëniet private (5,8%), informimi publik dhe mediat (4,5%) dhe fushat e tjera të marrëdhënieve shoqërore (përqindja individuale e ankesave më e vogël se 3%).

**Grafikoni: Fusha e diskriminimit**



**3.12.1 Puna dhe punësimi**

Si edhe në vitin 2011, edhe gjatë këtij viti më së shumti ankesa kanë arritur për shkak të diskriminimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe me rastin e punësimit. Në këtë fushë ankesat janë paraqitur në bazë të gati të të gjitha veçorive personale të cilat janë theksuar në Ligj për ndalimin e diskriminimit. **Gjithsej janë pranuar 163 ankesa (35,1%),** nga të cilat 80 i kanë paraqitur meshkujt, kurse 73 i kanë paraqitur gratë, dy ankesa janë dërguar në mënyrë elektronike, pa e theksuar gjininë dhe 8 ankesa i kanë paraqitur personat juridikë/organizatat.

Analiza e ankesave tregon se në fushën e punës dhe të punësimit ekzistojnë problemet me të cilat qytetarët dhe qytetaret po ballafaqohen, por që diskriminimit zakonisht i nënshtrohen grate, veçanërisht gratë shtatzënë dhe lehonat , si edhe personat me invaliditet dhe personat e moshuar.

- Paraqitësja e ankesës konsideron se punëdhënësi po e diskriminon në bazë të gjinisë, statusit martesor dhe familjar duke e marrë parasysh se pas kthimit në punë nga mungesa për kujdesin për fëmijën është vendosur në një vend më të ulët të punës. Nga punëdhënësi është kërkuar të dërgojë listën e të gjitha punëtoreve të cilat gjatë tri vjetëve të punës e kanë përdorur pushimin me leje të shtatzanësisë, me informatë se në cilat vende të punës kanë qenë të punësuar në momentin kur kanë shkuar në pushim të shtatzanësisë për t'u kujdesur për fëmijë, kurse në vende të punës janë kthyer pas shfrytëzimit të pushimit me leje të shtatzanësisë, si edhe në cilin vend të punës gjenden gjashtë muaj pas kthimit në punë. Kur e kemi shikuar dokumentacionin e dërguar kemi konstatuar se gjatë tri vjetëve 89 punëtore e kanë shfrytëzuar këtë pushim, nga të cilat 31 punëtore ende gjenden në pushim me leje të shtatzanësisë. Duke e marrë parasysh vetëm pozitën e punëtoreve të punësuar të cilat janë kthyer në vende të punës pas lejes së shtatzanësisë, është konstatuar se nga numri i përgjithshëm prej 58 punëtoreve 14 punëtoreve ua kanë dhënë vendin e punës më të ulët pas kthimit nga pushimi me leje të shtatzanësisë, gjë që është 24,14%. Këtij numri mund t'i shtohet edhe numri prej 18 punëtoreve të punësuar të cilat para se të shkojnë në pushim me leje të shtatzanësisë kanë punuar në vende më të ulëta të punës (arkatare, pastruese dhe kuzhiniere të cilat ziejnë kafe), dhe pas kthimit nga pushimi as që kanë mundur të vendosen në vende më të ulëta të punës. Në bazë të kësaj ankesë dhe të të dhënave të dërguara, ka filluar procedura strategjike.

**Mirëpo, shumica e ankesave nga fusha e marrëdhënieve të punës ka qenë e pabazë nga aspekti i Ligjit për ndalimin e diskriminimit.** Ky fakt dëshmon se qytetarët dhe qytetaret veçanërisht janë të ndjeshëm ndaj situatave dhe ngjarjeve të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, si edhe që në këtë fushë janë më të gatshëm të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të veta. Nga ana tjetër, edhe në këtë fushë është dëshmuar se mungon njohuria për vetë nocionin e diskriminimit, përkatësisht, që shumë paraqitës të ankesave secilin trajtim të pabarabartë e konsiderojnë diskriminim. Në numër të madh të procedurave në të cilat nuk ka pasur shkelje të të drejtave në vështrim të Ligjit për ndalimin e diskriminimit, paraqitësit e ankesave janë informuar për mundësitë të cilat i kanë në bazë të dispozitës me të cilën janë rregulluar marrëdhëniet e punës, parandalimi i keqtrajtimit në punë, ose janë ballafquar me organet e tjera kompetente.

*- Paraqitësja e ankesës e ka paraqitur ankesën kundër shkollës E.T. në P. dhe drejtorit për shkak të diskriminimit në bazë të invaliditetit në procedurën e punësimit. E ka theksuar se ka konkurruar për punë, derisa i ka pasur kualifikimet përkatëse, por drejtori e ka zgjedhur kandidatit tjetër sipas këtij konkursi. Paraqitësja e ankesës konsideron se si person me invaliditet ka përparësi me rastin e punësimit, përkatësisht, që drejtori i shkollës e ka për obligim në bazë të Ligjit për riaftësim profesional në punësim të personave me invaliditet të punësojë atë sepse është person me invaliditet.*

Për shkak të diskriminimit me rastin e punësimit, përkatësisht, me rastin e shpalljes së vendeve të lira, është **marrë rekomandimi i masave për realizimin e barazisë i cili është dërguar në adresa të 12 portaleve të internetit** të cilat botojnë shpallje për punë. Atyre u është rekomanduar që të mos i botojnë shpalljet për punë të cilat përmbajnë kushte diskriminuese për punësim, dhe këtë ato të cilat kanë të bëjnë me gjini, përkatësisht moshë, pamje të kandidatit /tes ose ndonjë veçori tjetër personale. Përfundim bëjnë situatat kur shpallja për punësim ka të bëjë me punën natyra e së cilës është e tillë ose puna kryhet në kushte të tilla që veçoria personale paraqet kusht të vërtetë dhe vendimtar për kryerjen e punës, nëse qëllimi i cili dëshirohet të arrihet me këtë njëmend është i arsyetuar. Gjithashtu, rekomandojmë edhe ndërmarrjen e të gjitha masave për t'u parandaluar mundësia e publikimit të shpalljeve për punë, të cilat, në kundërshtim me ligj, përmbajnë kushte diskriminuese për punësim.

Gjithashtu, Komesari për mbrojtjen e barazisë më 9 gusht të vitit 2012 i ka **dërguar rekomandim Shërbimit Kombëtar për punësim që të mos i botojë shpalljet për punë të cilat përmbajnë kushte diskriminuese për punësim**, dhe këtë ato që kanë të bëjnë me gjini, moshë, pamje të kandidatit/tes ose ndonjë veçori tjetër personale. Përfundim janë situatat kur shpallja për punësim ka të bëjë me atë punë natyra e së cilës është e tillë ose puna kryhet në kushte të tilla që veçoria personale paraqet kusht të vërtetë dhe vendimtar për kryerjen e punës, nëse qëllimi i cili dëshirohet të arrihet është i arsyetuar, në pajtim me nenin 16, paragrafi 3, i Ligjit për ndalimn e diskriminimit dhe nenit 22 të Ligjit për punë. Gjithashtu, është rekomanduar edhe ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për t'u parandaluar secila mundësi e publikimit të shpalljeve për punë, e cila, në kundërshtim me ligjin, përmban kushte diskriminuese për punësim.

### **3.12.2 Veprimi i organit të pushtetit publik**

Për shkak të diskriminimit në sjelljen para organeve të pushtetit janë paraqitur 18,1% ankesa. Zakonisht ankesat janë paraqitur kundër njësive të qeverisjes vendore dhe qyteteve, ministrive dhe institucioneve shëndetësore.



- Shoqata e personave me invaliditet e ka paraqitur ankesën kundër dy komisioneve të mjekëve të shkallës së parë dhe të dytë të cilat e përcaktojnë aftësinë trupore dhe shpirtërore të personave me invaliditet që drejtojnë automjete motorike. Në ankesë është theksuar se dy personat me invaliditet u janë drejtuar komisioneve kompetente të mjekëve sipas vendeve të vendbanimeve të veta, për të marrë vërtetim për aftësitë trupore dhe shpirtërore për të drejtuar automjetin. Të dy personat, secili nga ana e komisionit të vet kompetent i shkallës së parë, e ka marrë vërtetimin se nuk janë të aftë për të drejtuar automjete të përshtatura motorike. Pas kësaj të dy personat i janë drejtuar komisionit të mjekëve të shkallës së parë në qytetin tjetër, tjetër nga vendbanimi i tyre, ku e kanë marrë vërtetimin, se janë të aftë që të drejtojnë automjetet e përshtatura motorike. Duke e marrë parasysh se nga komisionet e ndryshme të shkallës së parë i kanë marrë dy vërtetime të kundërta të mjekut, komisioni i mjekëve i shkallës së dytë e ka marrë diagnozën dhe mendimin përfundimtar për të dy rastet, dhe këtë ashtu që të dy personat i ka shpallur të paaftë përgjithmonë për të drejtuar automjetet motorike. Në procedurën e zbatuar është konstatuar se të vepruarit në mënyrë të ndryshme të komisioneve të mjekëve është diskriminim i personave me invaliditet dhe u është dërguar rekomandimi komisioneve mjekësore që të njëjtësojnë praktikën kur është fjala për lëshimin e vërtetimeve të mjekëve me të cilat përcaktohet aftësia trupore dhe shpirtërore e personave me invaliditet që të drejtojnë automjetet motorike, si edhe që me rastin e këtyre vërtetimeve të kenë parasysh të arriturat e teknologjive moderne asistive.

- Kuvendi i Komunës së Svërligut e ka marrë Vendimin për financimin e çiftit bashkëshortor numër 400-136/2011-01 nga 15 shtatori i vitit 2011, me të cilën është parashikuar e drejta e çiftit bashkëshortor për ndihmë të njëhershme financiare e cila u paguhet bashkëshortëve njësoj pas lidhjes së martesës, dhe këtë në shumën prej 100.000 dinarësh, kurse për çiftet bashkëshortor të cilët jetojnë në fshat në shumën prej 150.000 dinarësh. Me këtë vendim Kuvendi komunal i Svërligut e ka shkelur parimin e të drejtave dhe obligimeve të barabarta, me çfarë ka bërë diskriminim ndaj disa kategorive të qytetarëve dhe të qytetareve të komunës së Svërligut ku në bazë të veçorive të tyre personale - vendbanimit dhe statusit martesor. Komunës së Svërligut i është dhënë rekomandimi që të mënjanojë të gjitha kushtet me të cilat është shkelur parimi i barazisë duke e suprimuar të drejtën për ndihmë financiare.

Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë i janë dërguar dy rekomandime të masave për realizimin e barazisë: 1) është rekomanduar që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në pajtim me autorizimet e veta, për të siguruar që në kuadër të të gjitha delegacioneve të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë në institucione parlamentare ndërkombëtare të jenë jo më pak se 30% të personave të gjinisë më pak të përfaqësuar, në pajtim me nenin 38, paragrafi 2 i Ligjit për barazinë gjinore dhe 2) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që në përbërje të të gjitha këshillave parlamentare të përfaqësohen në mënyrë të barabartë personat e gjinisë më pak të përfaqësuar, në pajtim me garancinë ku-



shtetuese të barazisë së meshkujve dhe femrave dhe obligimet e organeve shtetërore të zhvillojnë politikën e mundësive të barabarta.

### **3.12.3 Dhënia e shërbimeve, shfrytëzimi i objekteve dhe i sipërfaqeve**

Gjatë vitit të kaluar 33 ankesa janë paraqitur në fushën e dhënies së shërbimeve ose shfrytëzimit të objekteve dhe sipërfaqeve. Ankesat që i janë referuar shfrytëzimit të objekteve dhe sipërfaqeve publike gati janë paraqitur vetëm për shkak të diskriminimit në bazë të invaliditetit, kurse kur është fjala për dhënien e shërbimeve, si bazë e diskriminimit, theksohen edhe veçoritë e tjera.

O.l.p. nga N., në emër dhe me pajtimin e disa shoqatave të personave me invaliditet, i ka paraqitur ankesat kundër qytetit të N., dhe JP D. , për shkak të mos mënjanimit, përkatësisht mospërshtatjes së bordurës së rrugës në katër rrugë në N. Është konstatuar se përshtatja e bordurës së rrugës është në kompetenca të D.z. I. N., prandaj është zbatuar procedura unike dhe është marrë vendimi se është kryer akti i diskriminimit. Është dërguar edhe rekomandimi D.z.dhe N. që të sigurojë mënyrën e përdorimit të këtyre rrugëve, që të gjithë personave me invaliditet të cilët për të lëvizur i përdorin karrocet t'u mundësohet lëvizja e papenguar dhe shfrytëzimi i e sipërfaqeve publike.

- Paraqitësit e ankesave janë ankuar ndaj vendimit të Këshillit të qytetit S. me të cilin përcaktohet transporti falas për qytetarë më të moshuar se 65 vjet të cilët jetojnë në territorin e qytetit të S.m dhe e pohojnë që me përdorimin e këtij vendimi JP „S.t.“, si ndërmarrje kompetente për zbatimin e vendimit, ua ka suprimuar të drejtën për transport falas qytetarëve më të moshuar se 65 vjeç të cilët jetojnë në lagje periferike, ashtu që e ka caktuar që transporti falas ka të bëjë vetëm me qytetarë të cilët e kanë vendbanimin në lagje të qytetit. Është konstatuar se nuk është bërë diskriminimi i qytetarëve S. në bazë të vendbanimit, për shkak se me vendim është përcaktuar që të gjithë personat të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me vendim, kanë të drejtë të shfrytëzojnë falas transportin e qyteti T, pa e marrë parasysh faktin a jetojnë në qytet ose në lagje periferike.

### **3.12.4 Informimi publik dhe mediat**

Për shkak të diskriminimit në fushën e informimit publik dhe mediave i kemi marrë 21 ankesa. Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me tekstet e botuara në media të shtypit, kurse disa janë paraqitur për shkak të publikimeve në web faqet e internetit dhe në rrjeta shoqërore.

- Në tekstin autorial “Vetëm vjedhësit janë të zellshëm”, i cili është botuar në të përditshmen “P.”, janë shprehur idetë dhe qëndrimet të cilat janë shqetësuese, nënçmuese dhe paraqesin ofendim të dinjitetit të pjesëtarëve dhe të pjesëtareve të pakicës kombëtare rome, me çfarë është krijuar një ambient armiqësor, nënçmues dhe ofendues. Të përditshmes „P.“ i është rekomanduar që publikisht t’u kërkojë falje pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës kombëtare rome, për shkak të tekstit „Vetëm vjedhësit janë të zellshëm“.

- E përditshmja „B.“ është rekomanduar që më të mos publikojë vëzhgime me të cilat nënçmohen gratë dhe i përkrahin paragjykimet dhe modelet shoqërore të bazuara në role stereotipe të gjinive, dhe me vëzhgimet e veta të kontribuojnë që të ndryshojnë modelet, zakonet dhe praktikatat të cilat i kushtëzojnë stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimet në krahasim me gra.

### **3.12.5 Arsimi dhe aftësimi profesional**

Gjatë vitit 2012 janë paraqitur 38 ankesa për shkak të diskriminimit në fushën e arsimit dhe të aftësimit profesional. Ankesat dëshmojnë për një numër të madh të problemeve në fushën e arsimit, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijë nga grupet e marginalizuara (fëmijët e romëve, fëmijët me pengesa në zhvillim). Disa ankesa kanë të bëjnë me diskriminimin e fëmijëve të romëve në shkollë, si edhe me segregacionin e fëmijëve të romëve në shkolla fillore dhe në një institucion parashkollor. Është mjaft brengosëse që ekziston segregacioni i fëmijëve të romëve në arsim, dhe këtë plotësisht i hapur në disa institucione, siç janë Shkolla fillore „Aleksandar Stojanoviç Leso“ dhe PU „Mladost“ nga Pazari i Ri-Dezheva, fshati Blazhev-Vozhegërnci, në të cilat fëmijët e romëve nga familjet e të shpërnuglurve janë veçuar në klasë të veçanta dhe gjenden në një ndërtesë të veçantë, kurse në disa shkolla të tjera bëhet fjalë për problem të vazhdueshëm.

Në ankesë është theksuar se mbi 90% të nxënësve të Shkollës fillore „V. K.“ nga N. e përbëjnë fëmijët e kombësisë rome, kurse gjithsej nga dy deri tre fëmijë në një gjeneratë i takojnë popullsisë jorome. Edhe pse nuk është përcaktuar diskriminimi i fëmijëve të romëve, i është rekomanduar Drejtorisë për Arsim, Kulturë dhe Sport të qytetit të N. që në bashkëpunim me SHF „V. K.“, me Ministrinë e Arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, si edhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile, të fillojë përgatitjen e planit gjithpërfshirës të masave me realizimin e të cilit do të tejkalohet problem i segregacionit, domethënë i numrit të madh të fëmijëve të romëve në krahasim me fëmijët e tjerë në SHF „V. K. në N, në pajtim me Strategjinë për përparim të pozitës së romëve në Republikën e Serbisë. Me zbatimin e një plani të tillë të masave, brenda një afati të gjatë do të ndryshonte situata në SHF „V. K.“, kurse qyteti i N. do të ishte shembull pozitiv që do të mundë ta vijonin edhe qytetet dhe komunat e tjera.

## 4. Bashkëpunimi dhe përrurimi i barazisë

Gjatë vitit 2012, Komesarja për mbrojtjen e barazisë dhe të punësuarit në shërbim të Komesarit kanë marrë pjesë në konferenca të shumta të vendit dhe ndërkombëtare dhe në tryeza të rrumbullakëta, në shqyrtime dhe dëgjime publike, në tubime dhe seminare profesionale të cilat i kanë organizuar organet e pushtetit publik dhe organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, janë mbajtur ligjëratat dhe prezantimet e numërta për institucionin e Komesarit në mbarë Serbinë. Një pasqyrë komplete të tubimeve, ngjarjeve publike, tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Komesarit për mbrojtjen e barazisë është dhënë në Raportin integral të rregullt vjetor të Komesarit për vitin 2012.

Komesari për mbrojtjen e barazisë edhe në vitin 2012 ka pasur bashkëpunim të mirë me organet e tjera të pavarura shtetërore, e veçanërisht bashkëpunimi i mirë është realizuar me Mbrojtësin e qytetarëve. Në mes të vitit 2012, janë formuar dy grupe të përbashkëta të punës dhe Komesarit për mbrojtjen e barazisë, dhe këtë:

1) *Grupi punues për analizë të dispozitave me rëndësi për pozitën e personave me invaliditet në qarkullim juridik dhe në procedurat para organeve të pushtetit publik* – të formuara me detyrë që të identifikojë dhe analizojë dispozitat ligjore të cilat janë me rëndësi për pjesëmarrjen e personave me invaliditet në qarkullim juridik, si edhe për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me invaliditet në procedurat gjyqësore dhe në procedurat para organeve tjera të pushtetit publik. Grupin e punës e përbëjnë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile të cilat merren me të drejtat e personave me invaliditet, kurse qëllimi i punës së përbashkët është formulimi i propozimeve konkrete për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave në këtë fushë;

2) *Grupi punues për analizën e dispozitave me rëndësi për pozitën juridike të personave transgjisorë* – është formuar me detyrë që të identifikojë dhe të analizojë dispozitat e vendit, rajonale dhe ndërkombëtare juridike dhe standartet në këtë fushë. Grupin punues e përbëjnë ekspertë me përvojë shumëvjeçare, kurse qëllimi i punës së tyre është formulimi i rekomandimeve dhe propozimeve konkrete për ndryshime të legjislacionit të cilat do t'i kontribuojnë përparimit të pozitës së personave transgjisorë në Serbi

Në bashkëpunim me Mbrojtësin e qytetarëve dhe me përkrahjen e Fondit të Kombeve të Bashkuara për ndihmë fëmijëve në Serbi (UNICEF), është mbajtur më 28-30 nëntor të vitit 2012, në Kovaçicë, seminari për fëmijë “*Serbia: 0 diskriminimet!*“. Në seminar ka marrë pjesë Paneli i këshilltarëve të rinj i Mbrojtjes së qytetarëve dhe grupi i fëmijëve të cilët gjatë periudhës së ardhshme do ta përfaqësojnë grupin e të rinjve të Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

Edhe gjatë këtij viti ka vazhduar bashkëpunimi me organet e pushtetit publik. Komesarja për mbrojtjen e barazisë dhe të punësuarit në shërbim të Komesarit për mbrojtjen e barazisë, kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat i kanë organizuar organet e tjera shtetërore, siç janë konsultimet kombëtare, mbledhjet e grupeve profesionale dhe takimet për punë.

Gjatë vitit 2012 ka përparuar bashkëpunimi i Komesarit për mbrojtjen e barazisë me përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor. Në kuadër të Progresit të projektit “*Më shumë se ligji: Përurimi dhe zbatimi i legjislacionit antidiskriminues dhe i barazisë në Serbi*”, janë mbajtur dy trajnime për përfaqësuesit e organeve të drejtësisë, të destinuara për ngritjen e kapacitetit dhe përparimin në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Në bashkëpunim me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe përforcimin e grave (KB WOMEN), zyra në Serbi, me të cilën Komesari për mbrojtjen e barazisë e ka Memorandumin e nënshkruar për mirëkuptim, ka vazhduar bashkëpunimi me vetëqeverisjet vendore. Gjatë vitit 2011, janë zgjedhur 10 komuna dhe qytete<sup>54</sup> në të cilat ka filluar bashkëpunimi me pushtetet vendore, mekanizmat vendorë për barazi gjinore dhe zyrat për ndihmë juridike falas. Qëllimi i një bashkëpunimi të këtillë të drejtpërdrejtë është sigurimi i mundësisë që të gjithë qytetarët, e veçanërisht grate, të kenë mundësi të kontaktojnë me Komesarin për mbrojtjen e barazisë, përmes informimit më të madh të mekanizmave vendorë për barazi gjinore dhe zyra për ndihmë juridike falas për mandatin e Komesarit dhe rolin e tij në parandalimn e diskriminimi të bazuar në gjini.

Gjatë vitit 2012, edhe më shumë është shtuar bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Krahas tashmë bashkëpunimit të vendosur me përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare në Serbi dhe me organet e tyre të specializuara, si edhe zbatimit të aktiviteteve të rregullta në kuadër të anëtarësimit në Rrjetin e organeve evropiane për barazi EQUINET, institucioni i Komesarit e ka vendosur bashkëpunimin dhe ka zhvilluar partneritet edhe me organizatat e tjera. Udhëtimet për studime dhe takimet e punës me partnerët ndërkombëtarë kanë kontribuar për këmbimin e përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve të institucionit.

<sup>54</sup> Vetëqeverisjet vendore janë zgjedhur në bazë të kritereve më parë të përkufizuara, siç janë mbulueshmëria gjeografike, kapacitetet e mekanizmave vendorë për barazi gjinore dhe zyra për ndihmë juridike falas, përkushtueshmëria e komunave që të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, aktivitetet e deritashme, niveli i transparencës dhe bashkëpunimi i mëparshëm me Komesarin.

Gjatë vitit 2012, institucioni i Komesarit i ka organizuar dy tubime ndërkombëtare:

1) „Tryezën e përbashkët për barrën e dëshmimit në procedurat diskriminuese“, tubim rajonal i mbajtur më 11 maj të vitit 2012, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e organeve të pavarura të cilat merren me mbrojtjen nga diskriminimi nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Republika Serbe, Mali i Zi dhe Serbia. Në tubim është biseduar edhe për bashkëpunimin e ardhshëm të organeve për barazi në rajon.

2) Konferenca ndërkombëtare “Mediat dhe barazia”, e mbajtur më 19 tetor të vitit 2012, në të cilën kanë marrë pjesë gazetarët nga mediat e vendit, dhe ligjëruesit dhe moderatorët e punishteve kanë qenë ekspertët prestigjiozë dhe ekspertët e huaj.

#### **4.1 Përparimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të testuar diskriminimin sipas situatave**

Me Ligjin për ndalimin e diskriminimit, në pajtim me standardet ndërkombëtare antidiskriminuese, janë caktuar rregullat e veçanta për rindarjen e barrës së dëshmimit, por është rregulluar edhe mundësia e ekzaminimit vullnetar të diskriminimit, i ashtuquajtur testim sipas situatave.

Testimi sipas situatave e paraqet situatën eksperimentale, të krijuar me qëllim, që të verifikohet se a ka ose jo diskriminim në një situatë të caktuar shoqërore. Përdoret në situata kur dyshohet se ekziston diskriminimi, por kur ai, në shikim të parë, nuk vërehet.

Duke e pasur parasysh faktin se organizatat e shoqërisë civile janë aktorë të rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit, si edhe që janë partnerë strategjikë të Komesarit për mbrojtjen e barazisë, në gusht të vitit 2012, është shpallur konkursi për ndarjen e mjeteve financiare organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e testimit të diskriminimit sipas situatave. Qëllimi është përforcimi i kapacitetit të vetë organizatave në territorin e Republikës së Serbisë.

Në konkurs janë paraqitur 66 organizata të shoqërisë civile, kurse me rastin e zgjedhjes së organizatave kemi pasur kujdes për përfaqësimin e barabartë rajonal, si edhe për përfaqësimin e barabartë të grupeve të ndjeshme me të cilat punojnë organizatat (gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, invaliditeti dhe gjendja shëndetësore, mosha, përkatësia kombëtare dhe origjina etnike dhe veçoritë e tjera reale ose të supozuara). Janë zgjedhur 23 organizata, kurse nga dy përfaqësues nga secila organizatë e kanë ndjekur trajnimin për testimin e diskriminimit sipas situatave. Me përkrahjen e programit TASCO<sup>55</sup>, janë mba-

---

<sup>55</sup> Mbështetja teknike organizatave të shoqërisë civile, <http://tasco.org/Default.aspx>

jtur tri trajnime, në Kragujevc, në Nish dhe në Beograd, në të cilat kanë marrë pjesë 43 përfaqësues nga 22 organizata të shoqërisë civile. Me gjithsej 22 organizata janë lidhur marrëveshjet, përkatësisht, u janë ndarë mjetet në të holla në shumën prej 130.000 dinarësh. Organizatat e kanë për obligim që të bëjnë më së paku tri testime sipas situatave brenda afatit prej gjashtë muajsh, si edhe që për secilin testim të dërgojnë raport. Nëse gjatë testimit konstatojnë se ka pasur akt diskriminimi, organizatat kanë për obligim që t'i paraqesin ankesë Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

## **5. Media monitorimi i punës së Komesarit dhe të raportuarit për diskriminim**

Interesimi i mediave për punë të Komesarit në vitin 2012 është në rritje në krahasim me vitet e mëparshme. Shikuar sipas statistikës, gjatë vitit 2012, Komesari për mbrojtjen e barazisë dhe vetë Komesarja, gjithsej janë paraqitur në media 439 herë. Në media të shtypit janë botuar 309 artikuj në gazeta (deklarata, raporte, kumtesa, komente), kurse në media elektronike 130 vëzhgime, deklarata, kumtesa dhe pako TV me tema në të cilat përmendet ose është cituar komesarja për mbrojtjen e barazisë ose ndonjë nga të punësuarit në Shërbim profesional të Komesarit për mbrojtjen e barazisë.

Kur bëhet fjalë për raportim për diskriminim, teste dhe vëzhgime më së shumti janë botuar për personat LGBT, pastaj romët dhe pastaj për personat me invaliditet.

Analiza e raportimit të mediave të shtypit për grupet e theksuara të pakicave ka dëshmuar se numri më i madh i testeve edhe më tutje botohet lidhur me incidentet në të cilat pjesëtarët e këtyre grupeve kanë qenë viktime. Terminologjia jokorrekte është e pranishme në një masë të madhe, si edhe elementet e raportimit senzacional, pa qëllim të vërtetë që të theksohet ndonjë problem ose të përpunohet ndonjë temë. Raportimi më korrekt mund t'i atribuohet gazetës *Danas* dhe *Dnevnik*, të cilat më së shumti raportojnë për (mos)respektimin e të drejtave të njeriut dhe, duke e përdorur terminologjinë adekuate, i theksojnë problemet me të cilat takohen pjesëtarët e grupeve të diskriminuara të pakicave. Mediat në një masë të madhe janë marrë edhe me çështjen e barazisë gjinore dhe me pozitën e grave, me pjesëtarë të pakicave kombëtare, dhe veçanërisht me fushën e marrëdhënieve të punës në të cilën është i pranishëm numri më i madh i rasteve të diskriminimit sipas të të gjitha bazave. Ekziston një numër i dukshëm i teksteve të cilat dëshmojnë për shkaqet e pozitës së pavolitshme të grave dhe për mënyrat e zgjidhjes së problemit.

## 6. Projektet

Komesari për mbrojtjen e barazisë, gjatë vitit 2012, e ka realizuar një numër aktivitetesh në kuadër të projekteve, të cilat i realizon vetë ose në partneritet me organizatat e shoqërisë civile.

***Projekti “Më shumë se ligji: Përrurimi dhe implementimi i legjislacionit antidiskriminues dhe i barazisë në Serbi”, “Progresi i programit të Bashkimit Evropian.***

Projekti është implementuar në periudhën prej 15 dhjetorit të vitit 2011 deri më 15 dhjetor të vitit 2012. Në kuadër të komponentës së parë të projektit, qëllimi i të cilit ka qenë ngritja e kapacitetit të organeve të drejtësisë për aplikimin e ligjeve antidiskriminuese, është publikuar botimi “Mbrojtja qytetare-juridike nga diskriminimi”, i destinuar në radhë të parë për gjykatës, por edhe për të gjithë ata të cilëve u nevojiten njohuri nga kjo fushë. Janë mbajtur edhe punishtet lidhur me temën e mbrojtjes qytetare-juridike nga diskriminimi për përfaqësuesit e organeve të drejtësisë.

Komponenta e dytë e projektit i është kushtuar punës me përfaqësuesit e mediave për ngritjen e vetëdijes për fenomenin e diskriminimit dhe rolin e mediave në zhdukjen e diskriminimit. Është zbatuar hulumtimi voluminoz, i cili është botuar me emërtim “Mediat dhe diskriminimi në Serbi”. Janë mbajtur edhe disa punishte dhe janë organizuar dy udhëtime studimi për përfaqësues të mediave në Paris dhe në Romë. Në kuadër të kësaj komponente është botuar edhe doracaku “Mediat në Serbi, nga diskriminimi deri te barazia”, por është mbajtur edhe konferenca ndërkombëtare “Mediat dhe barazia”.

Komponenta e tretë e projektit i është kushtuar analizës së legjislacionit punues, nga aspekti i dispozitave antidiskriminuese. Është botuar doracaku me emërtim “Doracaku për luftën kundër diskriminimit në punë”, në të cilin janë analizuar standardet ndërkombëtare, legjislacioni kombëtar dhe praktika gjyqësore në këtë fushë.

***Projekti “Biblioteka e gjallë”, bashkëpunimi me Zyren e Këshillit të Evropës në Beograd***

Qëllimi i projektit është të zvogëlojë ndikimin e stereotipeve negative dhe paragjyqimeve si shkaktues kryesor të diskriminimit në shoqëri<sup>56</sup>. Janë mba-

---

<sup>56</sup> “Biblioteka e gjallë” paraqet metodologjinë inovative, e cila ka për qëllim përrurimin e të drejtave të njeriut, barazinë, luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë. Metodologjia e “Bibliotekës së gjallë” është specifike. Librat janë njerëz të gjallë, të zgjedhur me kujdes nga grupet shoqërore ndaj të cilave shpesh mbizotërojnë paragjykimet dhe stereotipet negative. Për shkak të pozitës së vet në shoqëri dhe përkatësisë një grupi të caktuar shoqëror, këta persona janë të stigmatizuar ose i nënshtrohen diskriminimit.



jtur gjashtë „Biblioteka të gjalla” (Smedereva, Pançeva, Kragujevci dhe tri në Beograd), në organizim të tyre deri më tani kanë marrë pjesë mbi 120 vullnetarë, kurse numri i përgjithshëm është rreth 2000. Përveç kësaj, janë mbajtur edhe tri trajnime kombëtare për organizues të „Bibliotekave të gjalla” (Ruma, Jagodina dhe Shabaci), kurse trajnimin e kanë bërë 64 persona, kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile.

### **„Që barazia të bëhet realitet”, Mbretëria e Norvegjisë**

Komesarit për mbrojtjen e barazisë i është lejuar në fund të vitit 2012, projekti “Që barazia të bëhet realitet”. Aktivitetet në projekt janë orientuar në pozitën e pakicave kombëtare dhe për përparimin e pozitës së popullatës LGBT në Serbi. Realizimi i projektit do të fillojë në vitin 2013.

### **„Shanset e barabarta për mundësi më të mire – përforcimi i romëve në luftën kundër diskriminimit”, Mbretëria e Holandës.**

Projekti realizohet nga muaji maj i vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013 në partneritet me organizatat Praksis dhe Qendra rajonale për pakica. Qëllimet kryesore janë ngritja e vetëdijes së popullsisë rome për rolin dhe kompetencat e Komesarit për mbrojtjen e barazisë, mekanizmat institucionalë për luftën kundër diskriminimit, si edhe edukimi për njohjen e akteve të diskriminimit dhe mënyra e paraqitjes së ankesës Komesarit. Projekti do të realizohet në 10 qytete dhe komuna në Serbi në lagjet e romëve.

### **Marrëveshja për bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për fëmijë në Serbi (UNICEF) në parandalimin e të gjitha formave të diskriminimit të fëmijëve.**

Në shtator të vitit 2012 Fondi i Kombeve të Bashkuara në Serbi dhe Komesari për mbrojtjen e barazisë e kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim shumëvjeçar për parandalimin e të gjitha formave të diskriminimit të fëmijëve. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është përforcimi i respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët, dhe veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë.

Në kuadër të fazës së parë (shtator 2012 - qershor 2013) janë zbatuar këto aktivitete:

- Trajnimi për të punësuar në zyren e Komesarit për mbrojtjen e barazisë, me qëllim që të përparohet puna analitike, mënyra e raportimit dhe zhvillimi i dokumenteve strategjike dhe i aktiviteteve të tjera të cilat duhet t’ua afrojnë punën e kësaj zyreje fëmijëve dhe të të rinjëve.

- Është botuar Libri me ngjyra “Të gjithë jemi të barabartë dhe mundemi bashkë”, i destinuar për fëmijë të moshës parashkollore.

- Është botuar broshura “Mos e lejo diskriminimin, kërko mbrojtjen dhe reag”, e destinuar për fëmijë të moshës prej 12 deri 16 vjeç.

- Është themeluar edhe Grupi i të rinjëve, të cilët gjatë periudhës së ardhshme do të bashkëpunojnë me Komesaren për mbrojtjen e barazisë. Është organizuar trajnimi triditor në të cilin të rinjtë do të mësojnë çfarë është diskriminimi, kanë mësuar cilat janë kompetencat e Komesarit për mbrojtjen e barazisë, në cilat problem hasin fëmijët me pengesa në zhvillim, për të drejtat për arsim për të gjithë e të ngjashme. Në trajnim kanë marrë pjesë edhe të rinjtë nga Paneli i këshlltarëve të rinj Mbrojtja e qytetarëve.

***„Përkrahja e institucionit të Komesarit për mbrojtjen e barazisë për zbatim efikas të legjislacionit antidiskriminues“, bashkëpunimi me Programin e Kombeve të Bashkuara për zhvillim (UNDP)***

Qëllimi i këtij projekti është përparimi i kapacitetit të institucionit të Komesarit për mbrojtjen e barazisë së Republikës së Serbisë për realizimin e plotë të rolit këshilldhënës dhe sigurimin e legjislacionit të harmonizuar për luftën kundër diskriminimit, ndërtimit të kapacitetit përmes bartjes së njohurive dhe analizën e praktikës gjyqësore krahasuese dhe përkrahjen zhvillimit të institucionit në aplikimin e zgjidhjes alternative të kontesteve me metodën e ndërmjetësimi. Me projekt është planifikuar vendosja e bazës së të dhënave për rastet e diskriminimit, ngritjen e kapaciteteve të të punësuarëve për përpunim të lëndës dhe për zhvillim të proceseve gjyqësore strategjike, si edhe vendosjen e bazës së ekspertëve të jashtëm, përkatësisht bashkëpunëtorëve.

Programi i Kombeve të bashkuara për zhvillim e ka mbështetur zbatimin e hulumtimit të opinionit publik për diskriminim në Serbi që për nevoja të Komesarit për mbrojtjen e barazisë e ka zbatuar Qendra për media të lira dhe për demokraci (CeSID) në nëntor të vitit 2012.

***“Implementimi i politikave antidiskriminuese në Serbi”, Zyra për të Drejta të Njeriut dhe të Pakicave - IPA 2011.***

Gjatë vitit 2010, në procesin e programimit IPA për vitin 2011, Ministria e atëhershme për të drejta të njeriut dhe të pakicave, e ka paraqitur propozimin e projektit i cili e ka përfshirë edhe Komesarin për mbrojtjen e barazisë, si përdorues të projektit. Këtë projekt tani është duke e zhvilluar Zyra për të drejta të njeriut dhe të pakicave.

Me aktivitete në këtë projekt IPA kemi filluar në mes të vitit 2012, me zgjedhjen e konsorciumit i cili do ta zbatojë projektin.

## 7. Veprimtaria botuese

Për përparimin dhe përrurimin e barazisë, mbrojtjes nga diskriminimi, si edhe informimit më të mirë të qytetarëve për punën e institucionit, Komesari për mbrojtjen e barazisë i ka botuar disa botime gjatë vitit 2012.

Raportin e rregullt vjetor të Komesarit për mbrojtjen e barazisë për vitin 2011, Beograd, 2012, fq. 108 (në gjuhën serbe dhe angleze);

- *Collection of Selected Opinions and Recommendations of the Commissioner for Protection of Equality*, Beograd, 2012, fq. 97 (në gjuhën angleze);
- *Hulumtimi: Mediat dhe diskriminimi në Serbi*, Beograd, 2012, fq. 74;
- *Mediat në Serbi: nga diskriminimi deri te barazia – doracak për gazetarë dhe gazetare*, Beograd, 2012, fq. 125;
- *Doracaku për luftën kundër diskriminimit në punë*, Beograd, 2012, fq. 151;
- *Mbrojtja gjyqësore qytetare-juridike nga diskriminimi*, Beograd, 2012, fq. 320;
- *Për Serbinë pa diskriminim*, Beograd, 2012, fq. 8;
- *Mos e tolero diskriminimin! Kërko mbrojtje dhe reago!*, Beograd, 2012, fq. 24;
- *Të gjithë jemi të barabartë dhe mundemi bashkë!*, Beograd, 2012, fq. 24;
- *Praktikumi për mbrojtjen nga diskriminimi*, Beograd, 2012, fq. 94 (në gjuhën serbe, angleze, hungareze dhe rome);
- *Çfarë është diskriminimi dhe si të mbrohemi prej tij? Versioni i thjeshtë për mbrojtjen nga diskriminimi*, Beograd, 2012, fq. 30.

Të gjitha botimet gjenden në formë elektronike në Prezantimin në internet të Komesarit për mbrojtjen e barazisë <http://www.ravnopravnost.gov.rs/lat/publikacije.php>.

## **8. Kryerja e obligimeve sipas ligjit për trajtim të lirë të informative me rëndësi publike**

Komesari për mbrojtjen e barazisë ua siguron trajtimin e lirë akteve të përgjithshme nga kompetenca e vet, me informata me rëndësi publike edhe me informata të tjera të cilat ua bëjnë të mundur qytetarëve që të njihen me punën e Komesarit. Në këtë vështirësi Komesari ua siguron trajtimin e lirë të informatave duke e njohtuar Kuvendin Popullor përmes raportit të rregullt vjetor, duke vepruar sipas kërkesave për trajtim të lirë informativ me rëndësi publike, duke e botuar Informatorin për punë, duke i botuar informatat në prezantim në internet.

Informatori për punën e Komesarit për mbrojtjen e barazisë për herë të parë është botuar më 29 dhjetor të vitit 2010 dhe që atëherë përmbajtja e tij azhurnohet dhe përparohet rregullisht. Informatori mund të gjendet në prezantimin në Internet të Komesarit për mbrojtjen e barazisë në adresën [www.ravnopravnost.gov.rs](http://www.ravnopravnost.gov.rs).

Gjatë vitit 2012, Komesarit për mbrojtjen e barazisë i janë paraqitur shtatë kërkesa për trajtim të lirë të informatave me rëndësi publike, për të cilat është dhënë përgjigja brenda afatit ligjor. Në krahasim me vitin 2011 kur kanë qenë gjithsej pesë kërkesa, në vitin 2012, shënohet një rritje e vogël në numër të kërkesave të paraqitura. Nga dy kërkesa i kanë paraqitur qytetarët dhe organizatat përkatësisht shoqatat, ndërsa tri i kanë paraqitur mediat.

## 9. Rekomandimet për zhdukjen e diskriminimit dhe përparimi i barazisë

Në raport për vitin 2011, në bazë të të dhënave të grumbulluara në procedurë sipas ankesave dhe këqyrjes së problemeve kryesore për realizimin dhe mbrojtjen e barazisë, janë dhënë 21 rekomandime zbatimi i të cilave do t'i a kontribuonte parandalimit më efikas dhe më të efektshëm për zhdukjen e diskriminimit.

Gjatë vitit të kaluar numri më i madh i këtyre rekomandimeve nuk është zbatuar, kurse plotësisht është zbatuar vetëm rekomandimi i cili ka të bëjë me plotësimin e Kodit penal me të cilin sigurohet dënimi adekuat i krimit nga urrejtja, domethënë veprës kryerja e së cilës është e motivuar me urrejtje të bazuar në racë, ngjyrë të lëkurës, përkatësi etnike ose kombëtare, konfesion, bindje politike ose tjetër, gjuhë, gjini, orientim seksual, indentitet gjinor, moshë, gjendje shëndetësore, invaliditet, arsim, pozitë shoqërore, origjinë sociale, gjendje pronësore ose ndonjë veçori tjetër personale. Në pikëpamje të numrit më të vogël të rekomandimeve janë marrë disa aktivitete.

Duke i marrë parasysh rekomandimet e dhëna më herët, nga të cilat numri më i madh edhe më tutje është aktual, në bazë të këqyrjes së fituar gjatë vitit të kaluar, po i japim këto rekomandime:

1. Të përfundojë punën në Strategjinë kombëtare për luftë kundër diskriminimit dhe të fillojë implementimi i tij.

2. Të realizohen masat e përcaktuara me dokumente kombëtare dhe vendore dhe me plane të veprimit me qëllim të mënjanimit të pengesave dhe rrethanave të cilat e pengojnë arritjen e barazisë së plotë të grupeve të deprivuara, të prekura dhe të marginalizuara shoqërore të: romëve, personave me invaliditet, personave të moshuar, personave të ikur dhe personave të shpërngulur brenda vendit, personave të varfër dhe personave të rrezikuar në aspektin social, duke përfshirë edhe fëmijët dhe gratë të cilat u takojnë këtyre grupeve, pa e marrë parasysh cilës forme të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë; të fillojë me kohë hartimin e strategjive të reja dhe të planeve të veprimit në pikëpamje të të cilave e thekson periudhën kohore për të cilën janë marrë.

3. Të ndërmerren masa që në programet mësimore dhe materialet mësimore të integrohen temat të cilat e zhvillojnë kulturën e paqes, tolerancës, mirëkuptimit dhe respektimit të qenët më ndryshe, barazisë gjinore dhe jodiskriminimit; Nga materialet mësimore të hiqen përmbajtjen të cilat i përkrahin stereotipet dhe paragjykimet dhe me edukim përkatës të arsimit të aftësohen që nxënësve t'ua zhvillojnë frymën e tolerancës dhe të qëndrimeve jo diskriminuese. Menjëherë të miratohet dhe të sigurohet aplikimi i Rregullores për kriteret e afërta për njohjen e formave të diskriminimit nga ana e punonjësit, nxënësit dhe personit të tretë në institucion të arsimit dhe të edukimit; të përgatitet dhe të realizohet plani i desegregacionit të fëmijëve të romëve në shkolla dhe në in-

stitucione parashkollore.

4. Të vazhdojë punën në integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha vendimet dhe politikat në nivel kombëtar, krahinor dhe lokal, si edhe puna në implementimin e masave për përmirësimin e pozitës së grave, veçanërisht grave nga grupet e marginalizuara shoqërore.

5. Të harmonizohen dispozitat për informimin publik me dispozita anti-diskriminuese; Të shtohet efektiviteti i punës i organeve rregulluese për zhdukjen e gjuhës së urrejtjes, dhunës, intolerances dhe qëndrimeve diskriminuese të cilat përhapen përmes mediave; Të sigurohet që shërbimet publike të radiodifuzionit dhe ndërmarrjet të përurojnë barazinë, tolerancën dhe diskriminimin, dhe që me veprimin e vet të kontribuojnë për ngritjen e vetëdijes së opinionit me ndryshimet e modeleve shoqërore dhe kulturore dhe zakoneve të cilat bazohen në stereotipe dhe paragjykime ndaj grupeve të pakicave dhe të marginalizuara shoqërore.

6. Të planifikojë dhe të realizojë masat të cilat do të sigurojnë që përbërja e organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes dhe organeve të tjera të pushtetit publik në masën më të madhe të mundshme t'i përgjigjet përbërjes kombëtare të popullsisë në zonën e tyre, gjë që e nënkupton shtimin e numrit të pjesëtarëve të punësuar të pakicave kombëtare në këto organe, duke përfshirë edhe shkollimin e tyre dhe aftësimin për ushtrimin e punëve në organe të pushtetit publik.

7. Të sigurohet që bartësit e shërbimit publik radiodifuziv të prodhojnë dhe të emitojnë programe të cilat me përmbajtje të veta e bëjnë të mundur shprehjen e identitetit kulturor të pakicave kombëtare dhe të grupeve etnike, duke përfshirë edhe krijimin e kushteve që programet t'i përcjellin edhe në gjuhën dhe alfabetin e vet.

8. Të përparojnë kapacitetet e këshillave kombëtare të pakicave kombëtare me qëllim të realizimit efikas të rolit të cilin e kanë në fushën e arsimit, kulturës, informimit në gjuhën e pakicës kombëtare dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe alfabetit.

9. Të krijojnë dhe të realizojnë programin e trajnimit të destinuar punëdhënësve të cilët do t'u ndihmojnë të zhvillojnë dhe të aplikojnë mekanizmat për vendosjen e parimeve të mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin në fushën e punës dhe të punësimit, parandalimin e të gjitha formave të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe administrimin me shumëllojlojshmëri në ambient pune; të përparojë punën e inspektorit të punës për zhdukjen e diskriminimit në punë dhe lidhur me punën.

10. Të sigurojë zbatimin efikas të dispozitave ligjore për arsim, punësim dhe riaftësim profesional të personave me invaliditet dhe të punojë në mënjanimin e pengesave të cilat e vështirësojnë përdorimin e objekteve, transportit, informatave, komunikimeve dhe shërbimeve të tjera publike.

11. Të përparojë njohuritë dhe aftësitë e nëpunësve policorë për reagim më efikas në raste të nxitjes së urrejtjes kombëtare, të racës dhe fetare dhe intolerances, të shkeljes së barazisë, diskriminimit në bazë të racës dhe diskriminimit në baza të tjera dhe veprave të tjera të motivuara me urrejtje.

12. Të vazhdojë punën për edukimin e gjykatësve, prokurorëve publikë dhe avokatëve në fushën e mbrojtjes qytetare-juridike dhe mbrojtjes kundërvajtëse juridike nga diskriminimi.

13. Të harmonizojë dispozitat juridike me të cilat janë rregulluar kushtet dhe procedura e regjistrimit të bashkësive jotradicionale fetare me të vendit, me standarde evropiane dhe ndërkombëtare për barazinë e kishave dhe të bashkësive fetare, për të parandaluar diskriminimin e tërthortë të këtyre bashkësive fetare dhe të vetë fetarëve.

14. Të aprovojë Ligjin për ndihmën juridike falas për t'ua siguruar viktimave të diskriminimit trajtimin e efektshëm të drejtësisë.

15. Të sigurojë hapësirën menaxhuese adekuate e cila i plotëson nevojat e shërbimit profesional të Komesarit dhe të mbështesë themelimin e zyrave rajonale të Komesarit.





CIP - Каталогизација у публикацији  
Народна библиотека Србије, Београд

341.231.14(497.11)"2012"(047.1)  
343.85:343.412(497.11)"2012"(047.1)

KOMESARI për mbrojtjen e barazisë raport i shkurtuar  
për vitin 2012. : raport i shkurtuar për vitin 2012. /  
[redaktore Nevena Petrušić]. - Beograd : Komesari për  
mbrojtjen e barazisë, 2013 (Beograd : Klik Tim).  
- 71 str. : graf. prikazi, tabele ; 24 cm

Izv. stv. nasl.: Скраћени годишњи извештај Повереника  
за заштиту равноправности за 2012. годину.  
- Тираж 200. - Str. 7: Нурје / Nevena Petrushiq.  
- Napomene i bibliografske reference uz tekst.

ISBN 978-86-88851-21-3

a) Људска права - Меѓународна заштита - Србија - 2012  
- Извештаји b) Дискриминација - Спречавање - Србија  
- 2012 - Извештаји  
COBISS.SR-ID 202774028

**Albanski jezik**

